



20 janar 2020

Aktiviteti i organizuar nga KLSH, kushtuar 100 vjetorit të krijimit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK)

" Një shekull shërbim i NIK-ut për shtetin polak"

Referati kryesor i mbajtur nga Kryetari i KLSH
Bujar Leskaj

TIRANA, ALBANIA

Përmbajtja e këtij leksioni është bazuar në librin në proces “GAO, NIK dhe leksionet e Dodaros” nga Bujar Leskaj.

Referuar pjesës së NIK-ut polak janë shfrytëzuar materialet e botimeve:

- 60 vjet INTOSAI, 50 vjet Sekretariati i Përgjithshëm
- Zyra e Auditimit Suprem të Polonisë, Tradita dhe Bashkëkohësia, përkthim i Astrit Beqiraj
- NIK-u polak 1919-2019, “Një shekull shërbim i NIK-ut në shtetin polak”, botim i NIK
- Broshura NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019
- Seria e Botimeve të KLSH 2012-2019
- Faqet web të NIK dhe KLSH

Ky botim është realizuar për nder të tre liderëve të spikatur të NIK-ut Polak Z. Jezierski, Z. Kwiatkowski dhe Z. Kutyla. Materiali është përgatitur përgjatë qëndrimit tremujor të fillimvitit 2019 të z. Bujar Leskaj pranë NIK-ut Polak.

Ky material u përgatit për botim edhe në variantin anglisht nga audituesit e KLSH:

Dorel Balliu

Redi Ametllari

Elsona Papadhima

I. Zyra Supreme e Auditimit e Polonisë festoi 100 vjetorin e themelimit të saj

Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë u themelua nga Kryetari i Shtetit, Józef Piłsudski, më 7 Shkurt, 1919. Për këtë arsye, 2019 ishte një përvjetor i veçantë për NIK-un polak.

Në fjalimin e tij në nder të përvjetorit të 100-të të NIK-ut, ish Presidenti Z. Kwiatkowski do të shprehej: *“Viti 2019, sikundër viti 2018, ishin të veçantë si për Republikën e Polonisë, ashtu edhe për Zyrën Supreme të Auditimit të Polonisë. Në nëntor 2018, Polonia celebroi përvjetorin e 100-të pavarësisë së saj. Në agim të pavarësisë, Kryetari i Shtetit Józef Piłsudski firmosi Dekretin mbi Zyrën Supreme të Auditimit Shtetëror; kështu, edhe NIK-u feston jubileun e tij të 100-të.*

Prej 100 vjetësh, NIK ka qenë rojtar i financave publike dhe i menaxhimit të përgjegjshëm të pasurisë publike polake, duke promovuar efektivitetin, efizienzën dhe ekonomicitetin e autoriteteve publike. NIK-u auditon të gjitha fushat e shpenzimit të fondeve publike, si të administratës në nivel qendror, ashtu edhe lokal, sikurse dhe ndërmarrjet dhe entet që përdorin fonde shtetërore dhe kanë detyrime financiare ndaj shtetit.”¹

NIK-u polak ishte ndër institucionet e para që u themeluan në Poloninë e rimëkëmbur dhe të pavarur. Që një shtet të operojë në mënyrë eficiente, është jetike ngritja e një institucioni kompetent auditimi me qëllimin ruajtjen e parasë publike, të pavarur nga ekzekutivi. Objektivat kryesore të Zyrës Supreme të Auditimit kanë mbetur të pandryshuara që nga Dekreti i 7 Shkurtit 1919. Funksonet e NIK-ut mbështeten mbi parime të përcaktuara qartë: qëllime transparente, informacion të besueshëm, auditues jopolitikë dhe vendime kolegjiale. Në këtë mënyrë, NIK-u përputhet plotësisht me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Me mbi 1000 punonjës, të ftuar, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar të auditimit dhe autoriteteve më të larta shtetërore, NIK-u festoi përvjetorin e 100-të në Teatrin e Madh të Operas në Varshavë. 175 punonjës të NIK-ut morën çmime dhe dekorata të ndryshme, duke përfshirë edhe 6 Urdhra të Lartë të “Polonia Restituta”.

Për herë të parë, krerët e tre organizatave ndërkombëtare lider të auditimit vizituan Poloninë njëkohësisht. Me këtë rast, NIK-u mirëpriti presidentët e INTOSAI-t, EUROSAT-t dhe ECA-s, të cilët morën pjesë edhe në konferencën ndërkombëtare mbi funksionimin e auditimit shtetëror në botën moderne.²

Ky celebrim i përvjetorit të NIK-ut polak vazhdoi përgjatë gjithë vitit 2019. Unë isha i ftuar në Degën Rajonale të Bydgoszcz nga Presidenti Kwiatkowski dhe u shoqërova nga ish zv. Presidenti z. Kutyla. Takimi ynë sot është kremtimi ynë për nder të përvjetorit të NIK-ut polak, i cili ishte planifikuar të organizohej në nëntor të 2019, por që u shtye për shkak të tërmetit që goditi Shqipërinë.

Kjo ceremoni mbahet për nder të shtetit polak, të NIK-ut polak, tre liderëve të tij të spikatur Z. Jezierski, Z. Kwiatkowski dhe Z. Kutyla, si dhe të Shkëlqesisë së Tij Z. Karol Bachura, ambasador i Republikës së Polonisë në Shqipëri.

¹ Gjatë fjalës së Presidentit të NIK-ut, Krzysztof Kwiatkowski për botimin "NIK 1919-2019, Zyra e Lartë e Auditit, Warsaw 2019", fq. 2.

² NIK 1919-2019, "Një shekull shërbim i NIK-ut për shtetin polak", Warsaw 2018. fq 69.

II.

Në këtë kumtesë do të përmend disa nga bazat e funksionimit e sistemit politik polak, marrë nga pjesa e botimit me të njëjtin emër “Hyrje në Sistemin Politik Polak”, të përgatitur nga Parlamenti polak në 2018. Ky botim numëron 4 pjesë:

Pjesa I: Konteksti historik, politik dhe kushtetues

Pjesa II: Proceset demokratike në veprim

Pjesa III: Institucionet kushtetuese

Pjesa IV: Sferat e politikës

Themelet aksiologjike të sistemit politik polak kanë të bëjnë me faktin se cilido sistem politik duhet të bazohet jo vetëm në institucione dhe procedura fikse, por edhe në parime e vlera. Këto parime dhe vlera janë:

- a. Sovraniteti i shtetit (në marrëdhëniet e jashtme) dhe sovrانيتeti i kombit (në marrëdhëniet e brendshme). Sovraniteti i kombit ishte një arritje e lëvizjes “Solidariteti” dhe u kalua pastaj në të gjitha partitë politike dhe lëvizjet e mëvonshme në kohën e pluralizmit, mbi bazën e idesë se shoqëria (polakët) duhet të ushtrojnë një ndikim përcaktues në fatet e vendit të tyre.
- b. Solidariteti social dhe perceptimi i Polonisë si një e mirë e përbashkët. Theksi në solidaritetin social u vu në kohët e “Solidaritetit” në vitet 1980-të dhe në moton e Papa Gjon Palit të Dytë “*Njëri me tjetërin dhe njëri për tjetërin; dhe jo njëri kundër tjetërit*”.
- c. Trashëgimia kristiane e shtetit dhe e kombit. Kjo trashëgimi rezultonte nga parimet e doktrinës së Kishës Katolike: dinjiteti i njeriut dhe ekonomia sociale e tregut.
- d. Pluralizmi social dhe politik, si një trashëgimi historike e kombit polak, e tolerancës së tij etnike dhe fetare, dhe nga ana tjetër, si refuzim i trashëgimisë komuniste.
- e. Balanca mes pushteteve, e konsideruar si komardarja më e mirë shpëtuese e patologjive të sistemit politik.

III. Dekalogu i risive të NIK-ut polak³

Bazuar në eksperiencën personale dhe në njohuritë e marra nga botime të ndryshme si: “Një shekull shërbim i NIK-ut për shtetin polak”, “Zyra e Auditimit Suprem të Polonisë, Tradita dhe bashkëkohësia”, “NIK 1919-2019”, kam përzgjedhur një dekalog risish nga NIK-u polak si në vijim:

1. NIK është një nga institucionet e para të Republikës së Dytë Polake (1918-1929) që ka dhënë një kontribut të madh në konsolidimin e Shtetit të ri polak gjatë periudhës 1919-1939.
2. Funksionimi i NIK gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore pranë qeverisë polake në mërgim në Francë dhe Britani të Madhe, si dhe veprimtaria e tij (i vetmi institucion i auditimit suprem në Evropë që e ka bërë) në ilegalitet në Poloninë e pushtuar nga nazistët (1942-1945). Me dhjetëra punonjës të Zyrës së Auditimit Suprem humben jetën ose u pushkatuan nga nazistët.
3. Evoluimi i NIK gjatë periudhës së Levizjes “Solidarność (Solidariteti)” (1980-1989) me fillimin e një institucioni suprem auditimi (SAI) modern të Evropës Perëndimore. Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë përfaqëson të vetmin SAI në Evropën Qendrore dhe Lindore (shtetet satelitore të Bashkimit Sovjetik) që pesoi ndryshime pozitive, nën influencën e Solidarnosht, në drejtim të një pavarësie të brishtë dhe të pushpallur të tij në auditim.
4. Shndërrimi i Zyrës së Auditimit Suprem (në drejtimin fillimisht të personalitetit me të spikatur politik dhe shtetëror në Poloninë e viteve 1990-2010, ish-Presidentit Lech Kaczyński) në një SAI modern, katalizator i ndryshimeve pozitive në ekonominë dhe shoqërinë polake të viteve 1992-2004 dhe kontribues me vlerë në anëtarësimin e Polonisë në Bashkimin Evropian.
5. NIK-u është SAI i vetëm presidenti i të cilit, reformatori Lech Kaczyński, u zgjodh si President i Republikës së Polonisë. Z. Kaczyński u afirmua si një personalitet i spikatur në gjirin e liderëve të EUROSAT-t.
6. NIK-u shërben si një SAI lider në komunitetin e INTOSAI-t sa i përket auditimeve mjedisore dhe mbrojtjes së biodiversitetit. Gjithashtu, NIK-u është identifikuar nga komuniteti i EUROSAT-t si një SAI tejet i rëndësishëm dhe me një kontribut madhor në shkëmbimin e eksperiencave të vlefshme të auditimit.
7. NIK-u jep një kontribut të paçmueshëm, sëbashku me INTOSAI-n, në implementimin e Agjendës së Kombeve të Bashkuara 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Për më tepër, NIK-u është caktuar edhe si auditues i jashtëm i organizatave ndërkombëtare si CERN, OECD, NATO dhe Kwshilli i Europës.
8. NIK-u ka qenë lider i grupit të task forcës në rishikimin e ISSAI-t 30, Kodi i Etikës, nën udhëheqjen e Presidentit Jezierski, kod i cili u aprovua në Kongresin e XXII-të të INCOSAI-t mbajtur në Abu Dhabi.
9. **NIK-u polak, si shkollë dhe universitet dijesh dhe njohurish:** Sikurse e përcakton presidenti i Polonisë Kaczyński në vitin 2008 në librin “NIK-u polak 1919-2019, Një shekull shërbim i NIK-ut në shtetin polak”: *“Në vendin tonë, NIK-u është një shkollë e shkëlqyer ku mund të fitosh njohuri dhe eksperiencë mbi funksionimin e shtetit polak. Mund të them se nuk kam parë kurrë më parë një shkollë më të mirë, megjithëse kam patur funksione të ndryshme në shtet – në qeveri, jashtë qeverisë dhe si Prokuror i Përgjithshëm. Asnjë autoritet tjetër shtetëror nuk të jep një pamje kaq të gjerë të situatës së shtetit në Poloni, sikurse ta jep Zyra e Auditimit Suprem.”*
10. NIK-u është partneri kryesor i KLSH-së në komunitetin e EUROSAT-t në përf forcimin e kapaciteteve audituese të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Historia e bashkëpunimit nis formalisht pas viteve '90. KLSH nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me ish-presidentin z. Janusz

³ NIK 1919-2019, NI “Një shekull shërbim i NIK-ut për shtetin polak”, Warsaw 2018

Wojciechowski në vitet 2000, por që nuk u implementua kurrë në praktikë. Ishte vetëm largpamësia, vullneti dhe gatishmëria e z. Jezierski e cila e kthyen KLSH-në dhe NIK-un polak në dy SAI-e partnere të çmuara. Ky partnership vazhdoi me sukses edhe nën presidencën e Z. Kwastkowski. Gjithashtu, NIK-u polak ishte dhe një ndër mbështetësit kryesor të anëtarësimit të Kosovës në komunitetin e INTOSAI-t, miratuar në Kongresin e XXIII-të të INCOSAI-t në Moskë.

IV. Historiku i NIK-ut dhe presidentët e saj në 100 vjet

Me një dekret të nënshkruar **më 7 shkurt 1919**, Zyra e Llogarive në Ministrinë e Thesarit, e cila vepronte gjatë Luftës së Parë Botërore u zëvendësua **nga Zyra Supreme e Kontrollit Shtetëror**, e cili ishte e pavarur nga qeveria dhe i pergjigjej vetëm Kryetarit të Shtetit. Kjo date shënon themelimin e institucionit modern të auditimit të Polonisë, i quajtur "NIK" për nga inicialet e emertimit të tij në polonisht (Najwyższa Izba Kontroli).

Periudha 1919-1926

Presidentet e parë të NIK-ut, Józef Higersberger dhe Jan Żarnowski, të cilët formuan bazën ligjore për kontrollin e Shtetit në vitet 1920, i dhanë Zyrës Supreme të Auditimit një trashëgimi të parimeve bazë të auditimit: pavarësinë e organit të kontrollit të lartë nga qeveria, kolegjaliteti dhe varesia ndaj Sejm (parlamentit polak).

Józef Higersberger, një avokat me përvojë nga Kongresi i Polonisë, President i Gjykatës së Apelit në Varshavë dhe Ministër i Drejtësisë në vitin 1918, u bë Kryetari i parë i Zyrës Supreme të Auditimit Shtetëror (1919-1921), i emëruar nga Kryetari i Shtetit, Marshalli Pilsudski.

Pasardhësi i Jozef Higersberger, Presidenti Jan Żarnowski (1921-1926), nën mandatin e të cilit institucioni njohu zhvillime të rëndësishme, luajti një rol të madh në përgatitjen e projektligjit të Zyrës Supreme të Auditimit. Ai përgatiti edhe udhëzimet e përgjithshme mbi mënyrën e kryerjes së auditimit nga ana e Kontrollit të Shtetit. Nevoja për të lëshuar udhëzime të tilla për kontrollorët u perceptual e plote nga Presidenti Żarnowski, i cili donte të standardizonte procedurat dhe metodat e dokumentimit të procedurave të auditimit sa më shpejt që të ishte e mundur. Żarnowski ishte gjithashtu një paraardhës i bashkëpunimit me autoritetet evropiane të auditimit. Żarnowski theksoi marrëdhëniet midis Zyrës Supreme të Auditimit dhe Sejm, si dhe nevojën për bashkëpunim të efektshëm midis këtyre dy organeve shtetërore.

Pozicioni aktual kushtetues i Zyrës Supreme të Auditimit është i një vlere të madhe, i konsoliduar nga një traditë polake shekullore dhe në përputhje me traditën evropiane.

Është e rëndësishme të theksohet se zhvillimi i Zyrës së Lartë të Auditimit të Shtetit polak u krye në kushte jashtëzakonisht të vështira. Përveç Luftës Polako-Sovjetike, e cila kryesisht përcaktoi fatin e Evropës në vitet në vijim, Polonia duhej të luftonte për pothuajse çdo kufi të saj.

Periudha 1926-1930

Pas vdekjes së Jan Żarnowski në tetor 1926, profesor Stanisław Wróblewski u bë Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit (1926-1930). Pas përfundimit të mandatit të tij, ai shërbeu si Sekretar i Përgjithshëm dhe më vonë President i Akademisë Polake të Mësimin. Vlen të përmendet se viti 1926 ishte i pari dhe i vetmi vit kur parlamenti polak trajtoi në detaje dy raporte vjetore të Zyrës Supreme të Auditimit.

Periudha 1930-1939

Generalin Jakub Krzemieński, një ish-legjionar dhe bashkëpunëtor i Kryetarit Piłsudski u emërua Presidenti i fundit i para-luftës i Zyrës Supreme të Auditimit (1930-1939). Gjatë drejtimit të tij, parimet dhe procedurat e auditimit u kodifikuan. Krzemieński futi për herë të parë garën në rekrutimin e

kontrollorëve të rinj. Që në vitin e parë të drejtimit të tij, për 50 vende të lira në Zyre pati 600 aplikime. Gara e hapur mundësoi tërheqjen e punonjësve me eksperiencë dhe kualifikim⁴.

Periudha 1940-1945

“Unë jam larg prezantimit të tendencave politike tek Auditimi: Unë do të mbroj rolin e madh të Auditimit në aparatit shtetëror, i udhëhequr vetëm nga ndërgjegjja ime”. Tadeusz Tomaszewski, Presidenti i NIK, 1940.

Pasi Gjermania dhe BRSS pushtuan Poloninë në shtator 1939, Zyra e Auditimit të Lartë u zhvendos në megrim, se bashku me qeverinë polake. Fillimisht në Francë dhe pas pushtimit të saj në vitin 1940, në Britaninë e Madhe.

Zyra Supreme e Auditimit ishte e detyruar të paraqiste komente mbi zbatimin e buxhetit për periudhën e mëparshme tek Presidenti i Republikës dhe Këshilli Kombëtar i Republikës së Polonisë në mërgim, i cili luante rolin e parlamentit polak, jo më vonë se gjashtë muaj nga data e marrjes së shlyerjes së përgjithshme të llogarive të të gjithë vendin nga Ministria e Financave dhe Thesari. Përveç kësaj, Zyra Supreme e Auditimit ishte e detyruar të sigurojë Presidentin e Republikës së Polonisë dhe Këshillin Kombëtar të Republikës së Polonisë një raport mbi aktivitetet e tij jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës buxhetore. Zyra kishte fuqi për të kryer rishikime të të ardhurave dhe shpenzimeve të emigracionit polak dhe autoriteteve të rezistencës polake brenda dhe jashtë vendit.

Në Poloninë të pushtuar, Zyra e Delegatit të Shtetit në Qeveri - një autoritet i lartë sekret administrativ- ishte aktive në rezistencën polake dhe auditonte fondet e transferuara nga Perëndimi, ndër të tjera. Struktura e saj përfshinte Seksionin e Auditimit, të krijuar në fillim të vitit 1942 për të kontrolluar shpenzimet e buxhetit në një cikël dy-mujor, duke zbatuar kriteret e ligjshmërisë, përshtatshmërisë dhe efikasitetit të kostos. Seksioni i Auditimit klandestin i Delegacionit Qeveritar në Poloni u emërua me kod të shifruar "Dhoma", "Nik" dhe "710".

Nga 1 dhjetori 1942, avokati Stanisław Peszyński e emërua Kryetar i Seksionit të Auditimit të delegacionit në Poloninë e pushtuar. Në gusht 1944, gjatë ditëve të para të Kryengritjes së Varshavës, nazisten e vrane Stanisław Peszynskin. Pas Kryengritjes së Varshavës, Sektori i Auditimit vijoi të operojë në Podkowa Leśna dhe Milanówek dhe përfundoi veprimtarinë e tij në gusht 1945.

Duhet theksuar se SAI polak përfaqëson të vetmin SAI të vendeve të pushtuara të Evropës Lindore dhe Qendrore që ishte aktiv dhe veproni në ilegalitet të plotë nën pushtimin nazist. Audituesit e tij vepronin nën rishikim të perhershëm të humbjes së jetës dhe disa prej tyre janë deshmorë të rezistencës polake.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1945, NIK ishte ndër institucionet e pakta të auditimit në të gjithë Evropën e pushtuar nga fashizmi, që funksionoi në mërgim, duke audituar aktivitetin e qeverisë në mërgim në Londër, si dhe në mënyrë ilegale në Poloni. Gjatë punimeve për ristrukturimin e godinës së vjetër të NIK në Varshavë, u zbulua në një nga muret e saj shenja karakteristike e rezistencës polake gjatë pushtimit fashist, sidomos gjatë Kryengritjes së Varshavës “Warsaw Uprising” në periudhën 1 gusht 1944-2 tetor 1944, një nga aktet më sublimë të luftës së popullit polak për liri, që pa shkatërrimin e një qyteti të tërë dhe ku edhe Zyra ka deshmorët e saj. Sot ky mur i ruajtur ashtu si 75 vjet më parë, është vend reflektimi dhe meditimi për punonjësit e NIK dhe jo vetëm për ta.

« Solidariteti » dhe një « finale » e gjatë e demokracisë 1945-1990

Lëvizja demokratike “Solidarnos” përfaqëson një rizgjim jo vetëm për demokracinë polake por edhe për vet NIK-un, i cili gjatë komunizmit qëndronte i izoluar nga simotrat europiane. Një panoramë të izolimit të NIK gjatë komunizmit e jep me mjeshtëri z.Jezerski në reflektimet e tij mbi INTOSAI-n si organizate globale të SAI-ve, ku shprehet se (citoj) “Si president i Zyrës Supreme të Auditimit të

⁴ Mbështetur në botimin jubilar të NIK në anglisht “1919-2019: Zyra Supreme e Auditimit-Një shekull i NIK në shërbim të Shtetit Polak”, Varshavë, 2019, fq. 56 dhe në botimin “Zyra Supreme e Auditimit: Tradita dhe Bashkëkohësia”, me autorë Danuta Bolikowska dhe Wojciech Robaczyński, Varshavë, 2014, përkthyer në shqip nga KLSH, 2018, fq. 59.

Polonisë (NIK), më duhet ta pranoj se institucioni im, ndonëse ishte anëtar i INTOSAI-t që prej fundviteve të 1950, nuk ishte i përfshirë për një kohë të gjatë në bashkëpunime dhe anëtarësia e tij ishte e kufizuar me kontakte formale kryesisht në nivelin e drejtuesve të lartë. Në vitet 1970, ndonëse Presidenti i NIK-ut ishte madje anëtar i Bordit Drejtues të INTOSAI-t, nuk pati asnjë promovim të ideve demokratike të INTOSAI-t në Poloni dhe nuk pati as mbledhje informacioni mbi mënyrën sesi ishin organizuar organet audituese në vendet e tjera, cilat ishin mandatet dhe metodat e tyre të punës (Deklarata e Limës e vitit 1977 u përkthye në Polonisht në vitin 1992!)⁵

Protestat sociale që kontribuan në krijimin e "Solidaritetit" (Sindikata e Pavarur e Vetëqeverisjes) në gusht të vitit 1980, duke mbledhur së bashku 10 milionë qytetarë, gjithashtu paten ndikim të madh në historinë e NIK. Duke pasur parasysh censurën më të butë nga ndikimi i Solidarnos, rezultatet e auditimeve të kryera nga Zyra në fund të viteve 1970-te filluan të bëhen publike në fillim të viteve 80-te. Kjo e ngriti autoritetin e Zyrës Supreme të Auditimit dhe Presidentit të saj te atëhershëm. Rëndësi të veçantë ishin auditimet e kryera nga NIK në fillim të viteve 1980-te lidhur me mashtrimet e kryera për përfitime private nga anëtarët e elitës komuniste (duke përfshirë auditimin e famshëm të rezidencës së figurave të shquara, ndarjen e veturave për bonot ose aktivitetet e Radios dhe Komitetit të Televizionit Shtetëror).

Gjetjet kryesore të auditimeve të saj sollën skandale të njepasnjeshme në Perendim, pas publikimit të tyre në disa gazeta dhe revista polake që botoheshin jashtë vendit. Abuzimet e zbuluara u denoncuan edhe nga Radio "Wolna Europa [Stacioni polak në mërgim i Evropës së Lirë]".

Audituesit e NIK i kaluan me kurajo në Perendim dokumente sekrete të auditimit të NIK mbi pronat dhe privilegjet e udhëheqësve të lartë të partisë komuniste polake (përfshirë gjeneralin Jaruzelski), të cilat u botuan nga revista "Kultura mujore" në Paris në vitin 1983.

Nga viti 1982 deri në vitin 1989, vala e grevave që përfshiu vendin detyroi qeverinë komuniste që në pranverën e 1989 të lejonte zgjedhje pjesërisht të lira për Sejmin dhe Senatin. Kandidatët e Komitetit të Qytetarëve të Levizjes "Solidariteti" i fituan të gjithë vendet e deputetëve të caktuara për opozitën dhe 99 nga 100 vendet e Senatit.

Në dhjetor 1990, Presidenti i Republikës së Polonisë u zgjodh figura e shquar polake, Lech Wałęsa, ish-drejtuesi i Solidarnos, duke u bërë kështu i pari President jo-komunist i vendit.

Me ardhjen e Walesës, nisi riorganizimi dhe modernizimi i institucioneve shtetërore polake, ku riorganizimi i Zyres Supreme të Auditimit (NIK) luajti një rol të rëndësishëm në reformimin e Shtetit polak të kohës. Aktiviste të Levizjes "Solidariteti" u pranuan në stafin e NIK. Ekipi i audituesve të NIK, i drejtuar nga aktivisti i opozitës Anatol Lawina zbuloi skandalin më të madh financiar në Poloni në atë kohë - FOZZ [Skandali i Shërbimit të Borxhit të Jashtëm të Polonisë].

Në maj të vitit 1991, puna për përcaktimin e konceptit të auditimit shtetëror, në linjë me modelet e miratuara në vendet e Evropës Perëndimore, filloi nën drejtimin e Presidentit të parë të Zyrës Supreme të Auditimit që vinte nga levizja "Solidariteti", të sapozgjedhur nga Sejmi, Prof. Walerian Pankos. Ai ishte një avokat, Kryetar i Komitetit të Pushtetit Lokal dhe bashkëautor i reformës së qeverisjes lokale në Poloni.

Presidenti i ri filloi të mblidhte një ekip punonjësish që kishin përpara një detyrë inovative - të reformonin institucionin. Ky proces u ndërpre nga vdekja tragjike e Presidentit Pańko në një aksident me makinë më 7 tetor 1991. Në këtë kohë të vështirë ndryshimi, plot pasiguri, audituesit e Zyrës i kryenin rregullisht auditimet, në mënyre sistematike dhe me përkushtim, duke zbuluar parregullsi serioze në funksionimin e shtetit.

⁵ Reflektime të ish-Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit (NIK) të Polonisë, Jacek Jezierski, botuar në botimin "60 vjet INTOSAI-50 vjet Sekretariati i Përgjithshëm", 2013.

Lech Kaczyński, reformatori me i madh i NIK (1992-1995)

Më 14 shkurt 1992, gjatë seancës plenare të Sejmimit në raundin e parë, Lech Kaczyński u votua dhe emërua President i Zyrës Supreme të Auditimit dhe më 27 shkurt 1992 Senati polak e konfirmoi emerimin. Që në fillim të punës së tij, Lech Kaczyński vuri në jetë vizionin përparimtar të tij se Zyra Supreme e Auditimit "*si institucioni auditues kryesor i Shtetit duhet të rindërtohet sa më shpejt dhe sa më tërësisht të jetë e mundur, që të bëhet një vëzhgues i plotë dhe një korrektor i besueshëm i transformimeve në fusha të ndryshme të jetës shtetërore*". Në Poloni, në gjysmën e parë të viteve 90-te ishin të shpeshta ndryshimet midis qeverive. Gjatë tre viteve të tij në krye të NIK, Lech Kaczyński kontrolloi zbatimin e buxhetit të shtetit nga katër qeveri.

Avokat polak dhe politikan. Shërbeu si President i Zyres Supreme të Auditimit në vitet 1992-1995, me vone si Kryetar i Bashkisë së Varshavës në vitet 2002-2005 dhe si President i Polonisë nga viti 2005 deri në vdekjen e tij në një aksident të dyshimte ajror në Aeroportin Verior të Smolensk-ut në Rusi në vitin 2010.

Në vitet 1970 Kaczyński ishte një aktivist në lëvizjen pro-demokratike antikomuniste në Poloni "Komiteti i Mbrojtjes së Punëtorëve" si dhe lëvizjen sindikaliste të pavarur. Në gusht 1980, ai u bë këshilltar i Komitetit të Greves së Ndërmarrjeve në kantierin detar të Gdańsk-ut dhe i lëvizjes "Solidariteti". Pasi komunistët vendosën ligjin ushtarak në dhjetor 1981, ai u internua si një element antisocialist. Pas lirimit të tij, ai u kthye në aktivitetet e sindikatës, duke u bërë një anëtar i lëvizjes në ilegalitetet « Solidariteti ».

Kaczyński u bë President i Zyres Supreme të Auditimit (NIK) nga shkurti 1992 deri në maj 1995 dhe bëri epokë në këtë institucion. Më vonë u bë Ministër i Drejtësisë dhe Prokuror i Përgjithshëm. Gjatë kësaj kohe Lech Kaczyński gëzoi mbështetje të gjere popullore për shkak të qëndrimit të tij të fortë kundër korrupsionit.

Në vitin 2001, ai themeloi partinë politike "Ligj dhe Drejtësi", se bashku me vëllain e tij dhe e drejtoi këtë parti si Kryetar i saj në vitet 2001-2003. Me 23 dhjetor 2005, Lech Kaczyński behet President i zgjedhur i Republikës së Polonisë.

Gjatë mandatit të tij si President, në planin e brendshëm, Lech Kaczyński i shërbeu me perkushtim rritjes së solidaritetit shoqëror në Poloni, sjelljes përpara drejtësisë të atyre që ishin përgjegjës për krime penale dhe ekonomike, rehabilitimin dhe mbështetjen sociale e shtetërore për ata që u prekën nga krimet komuniste, luftën pa kompromis kundër korrupsionit, arritjes së një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe sigurinë për zhvillimin e familjes. Ai deklaroi se do të kërkojë të heqë pabarazitë ekonomike midis rajoneve të ndryshme të Polonisë. Kaczyński pati si qasje politike gërshtimin e modernizimit të vendit me traditën dhe zbatimin e mësimëve të Papa Gjon Pali II.

Më 21 dhjetor 2008, Presidenti Kaczyński u bë kreu i parë i shtetit polak që vizitoi një sinagogë polake, për të marrë pjesë në shërbimet fetare të mbajtura atje. Kaczyński përkujtoi shumë heronj kombëtarë të Polonisë, të njohur si ushtarë të mallkuar që u zhdukën në duart e policisë sekrete polake, NKVD-së Sovjetike dhe organeve të tjera shtypëse të sundimit komunist.

Më 9 tetor 1992, Presidenti Lech Kaczyński emëroi një komision të NIK për të hartuar ligjin integral të Kontrollit Suprem të Shtetit. Pas gati një viti pune, si rezultat i shumë diskutimeve mbi formën e autoritetit suprem të kontrollit të shtetit dhe në sajë të përfshirjes së mendimit të të gjithë drejtuesve dhe njësive organizative të Zyres, u hartua një ligj modern që përcaktoi rolin e NIK në periudhën e ndryshimeve themelore të sistemit qeverisës në Poloni.

Miratimi i Aktit dhe hyrja e tij në fuqi në mes të vitit 1995 ishte një moment historik në modernizimin e auditimit me të lartë shtetëror në Poloni. Ai përforcoi pozitën e Zyrës Supreme të Auditimit si autoriteti suprem i kontrollit shtetëror, i cili varet dhe i jep llogari ekskluzivisht Sejmimit.

Lech Kaczyński ishte i vetëdijshëm se duke prezantuar me ligj mandatin e Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit, ai do të humbiste pozitën e tij. Megjithatë, ai besonte se kjo ishte një garanci për

pavarësinë e institucionit. Akti u bë simbol dhe kulmi i presidencës së Lech Kaczyński, i cili, duke zbatuar dispozitat ligjore, e përfundoi drejtimin e tij trevjeçar të Zyrës në qershor të vitit 1995 dhe u la pas pasuesve të tij një ligj modern, të përshtatur me kërkesat e kohës, gjithëpërfshirës dhe që e poziciononte denjesisht NIK në mes të partnereve të tij në vendet e Evropës Perëndimore dhe Bashkimit Evropian.

"Detyra e Zyrës Supreme të Auditimit nuk është të zbulojë skandale. Në auditime mekanizmat e operacioneve shtetërore dhe në një mënyrë të njëkohshme zbulojmë çështjet që janë përshkruar në kodin penal. Zbulimi i skandaleve nuk është një qëllim në vetvete, por më tepër një efekt anësor i punës sonë. Gjithmonë ka qenë kështu dhe kështu do të jetë gjithmonë". Lech Kaczyński, 1992

"Duhet të thuhet qartë se vlerësimi i politikës së privatizimit të shtetit nuk është as roli as edhe qëllimi i drejtuesve të Zyrës Supreme të Auditimit. Roli i Zyrës Supreme të Auditimit është të auditojë procesin e transformimit të pronësisë në aspektin e ligjshmërisë, efektivitetit të kostos dhe sigurimit të interesave të thesarit të shtetit. [...] Megjithatë, është e qartë se kaosi organizativ dhe institucional tregon nevojën për të organizuar dhe stabilizuar institucionet qeveritare që kryejnë transformimet e pronësisë në ekonominë kombëtare". Lech Kaczyński, Kryetari i Zyrës Supreme të Auditimit, fjalim në Sejm më 3 shtator 1992

Çfarë të bën përshtypje në këtë fragment të fundit nga mendimet e tij, është qartësia e thellë e Presidentit vizionar të NIK Lech Kaczyński ndaj postulatit se institucionet supreme të auditimit nuk auditojnë politikën e qeverisë, por vetëm rezultatet e zbatimit të tyre, postulatit i pranishëm në të gjitha deklaratat dhe mesazhet e GAO-s amerikane dhe të liderit të saj, Gene L. Dodaro.

Periudha 1995-2001⁶

Janusz Wojciechowski, i emëruar në pozitën e Kryetarit të Zyrës Supreme të Auditimit në qershor 1995, e vijoi bashkëpunimin dinamik të nisur nga Kaczyński, midis Zyrës Supreme të Auditimit dhe institucioneve të tjera të auditimit suprem. Gjate periudhës 1995-2001, Zyra zgjeroi bashkëpunimin e saj në kuadër të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, si dhe me Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA).

Viti 1999 ishte i rëndësishëm për aktivitetet ndërkombëtare të Zyrës Supreme të Auditimit: Polonia u bë anëtare e plotë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe NIK nisi bashkëpunimin me Bordin Ndërkombëtar të Audituesve për NATO (IBAN). Në vitin 1999, Zyra u bë SAI koordinatore i Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimin Mjedisor dhe e mbajti këtë pozicion për nëntë vjet.

Periudha 2001-2004: NIK përballë sfidave të integritetit evropian të Polonisë⁷

Gjysma e dytë e viteve 90-te është një periudhë e përgatitjeve intensive të Polonisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Para pranimit, Zyra Supreme e Auditimit përballoi dy sfida dhe detyra të mëdha. Detyra e parë ishte kontrolli i strukturave të shtetit në drejtim të përgatitjeve të tyre për të përmbushur kërkesat e pranimit për në BE. Detyra e dytë ishte ndërmarrja e procesit të ndryshimeve të brendshme, duke e përshtatur NIK me pozicionin dhe rolin e organit suprem të auditimit të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian. Këto fusha ishin përparësia e punës së Presidentit **Mirosław Sekuła**, pas marrjes së mandatit të drejtimit të NIK në korrik 2001.

Në nëntor të vitit 2003, në Raportin Gjithëpërfshirës të Monitorimit mbi përgatitjet e Polonisë për anëtarësim në BE, Komisioni Evropian njohe se *"NIK është një organizatë e pavarur dhe profesionale dhe shërbimet e saj të auditimit në mënyrë të kënaqshme kontrollojnë të gjitha fondet publike dhe të BE-së"*.

⁶ Mbështetur në botimin jubilar të NIK në anglisht "1919-2019: Zyra Supreme e Auditimit-Një shekull i NIK në shërbim të Shtetit Polak", Varshavë, 2019 dhe në botimin "Zyra Supreme e Auditimit: Tradita dhe Bashkëkohësia", me autorë Danuta Bolikowska dhe Wojciech Robaczyński, Varshavë, 2014, përkthyer në shqip nga KLSH, 2018.

⁷ Mbështetur në botimin jubilar të NIK në anglisht "1919-2019: Zyra Supreme e Auditimit-Një shekull i NIK në shërbim të Shtetit Polak", Varshavë, 2019 dhe në botimin "Zyra Supreme e Auditimit: Tradita dhe Bashkëkohësia", me autorë Danuta Bolikowska dhe Wojciech Robaczyński, Varshavë, 2014, përkthyer në shqip nga KLSH, 2018.

Zyra që nga viti 2001 boton revisten shkencore Kontrola Państwowa ("Auditimi Shtetëror"), ndërsa në vitin 2006 ka nisur botimin e buletinit periodik "Przegląd Metodyczny" ("Rishikimi i Metodologjisë së Auditimit"), nga Departamenti i Strategjisë së Auditimit.

"NIK percepton privilegjin e tij kushtetues për të bërë vlerësime thelbësore të veprimtarive të institucioneve publike si një bashkëpërgjegjësi për ndërtimin e një shteti të fortë. Kjo është arsyeja pse raportet tona, përveç identifikimit të dukurive të pafavorshme, rekomandojnë specifikisht veprimet korrektuese dhe ofrojnë shembuj të praktikave të mira që synojnë të forcojnë mekanizmat e funksionimit eficient të shtetit".

Jacek Jezierski (2007-2013)

Më 22 gusht 2007, Jacek Jezierski u emërua President i NIK (2007-2013). Për herë të parë në historinë e institucionit, një kandidat që erdhi direkt nga personeli i auditimit të Zyrës u bë drejtues i saj. Ai u përball me shumë sfida, nga të cilat më e rëndësishmja ishte lufta për të ruajtur pavarësinë e Zyrës Supreme të Auditimit, përballë ndryshimit të Ligjit integral të NIK të vitit 1994.

Ideja pas amendimit të Ligjit për Zyrën Supreme të Auditimit ishte që ai të përshtatej me disa nga zgjidhjet e Kushtetutës së Republikës së Polonisë të vitit 1997, për të thjeshtuar procedurat e auditimit dhe për të shkurtuar kohëzgjatjen e tyre, si dhe për ta bërë atë më transparent dhe më miqësor ndaj subjekteve të audituara.

Ndryshimet që rezultojnë nga ndryshimi i Ligjit për Zyrën Supreme të Auditimit kanë të bëjnë me transparencën e rezultateve të auditimit: informatat mbi gjetjet e auditimit mund të bëhen të disponueshme edhe para publikut përpara se sa t'i kalojnë Sejm. Detyrimi për të publikuar, duke iu nënshtruar dispozitave për fshehtësinë e mbrojtur me ligj, u prezantua në deklaratat pas-auditimit dhe dokumentet e tjera të reja të dorëzuara në Sejm.

Kjo çoi në forcimin e hapjes dhe transparencës së aktiviteteve të NIK dhe, në të njëjtën kohë mundësoi zbatimin e duhur të së drejtës kushtetuese për qasje të pakufizuar në informacionin publik. NIK gjatë presidencës së Jezierskit u fokusua jo vetëm në zhvillimin e komunikimit me palët e jashtme të interesit, por edhe në zhvillimin e komunikimit të brendshëm. Kjo u bë e mundur falë fillimit të një rrjeti modern multimedial të *intranet*-it. Përdorimi i mjeteve moderne të IT-së, si videokonferencat dhe mbi të gjitha, Audituesi Mobil, bëri të mundur përdorimin e potencialit të auditimit të Zyrës në një mënyrë më të mirë.

Sipas Kutyla-s, *"E veçanta e institucionit polak të auditimit është se përpara se sa të vendosë për një program auditimi, thërret një panel me ekspertë të jashtëm, duke realizuar një tryezë pune dhe debati me ta"*.⁸

Gjatë mandatit të Presidentit Jezierski, Zyra e Lartë e Auditimit u përfshi fort në auditime paralele të kryera me SAI-t e shumë vendeve të BE-së dhe më gjerë. Auditimet trajtonin çështjet kryesore në mbrojtjen e mjedisit dhe në bashkëpunimin ndërkufitar. Në vitin 2007, së bashku me Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA) dhe autoritetet e auditimit nga shtatë vende, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara, audituesit e NIK kryen një auditim të përdorimit të fondeve ndërkombëtare për të eliminuar efektet e katastrofës së Çernobilit.

Si shprehje e vlerësimit për përpjekjet e Zyrës Supreme të Auditimit për të zhvilluar bashkëpunimin me institucionet simotra të auditimit suprem publik (SAI-t), NIK-ut iu besua roli i SAI-t organizator të Kongresit të VII-të të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI), mbajtur në Krakov në qershor 2008, me mbi 200 pjesëmarrës nga 57 vende.

Auditimet kryesore të kryera nga NIK në vitet 2007-2013 kanë prekur fusha me interes jetik për qytetarët, si: komercializimi i spitaleve, gjykimet klinike, transplantet e organeve, parandalimi

⁸ Botimi në anglisht "Zyra Supreme e Auditimit 1919-2019: Një shekull shërbimi të NIK ndaj shtetit polak", fq. 396, paragrafi i parë

onkologjik, të drejtat e pacientëve në spitalet psikiatrike, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, jetimoret, edukimi fizik në shkolla etj.

“Viti 2009 ishte një vit i punës intensive për ndryshimin e Ligjit për Zyrën Supreme të Auditimit. Ai përfshinte një numër ndryshimesh të rëndësishme dhe të domosdoshme, por edhe zgjidhje që mund të kufizojnë pavarësinë e kontrollit shtetëror. Përcaktimi i pasaktë i fushës së auditimit të jashtëm, i cili duhet t'i nënshtrohet Kontrollit të Lartë të Auditimit, bën të mundur vlerësimin e aktivitetit të auditimit të Zyrës Supreme të Auditimit, duke minuar pozitën e saj kushtetuese të një institucioni suprem të auditimit. Do të doja t'ju kujtoj se kontrolli shtetëror i pavarur nga pushteti ekzekutiv përbën bazën e një shteti demokratik dhe transparencën e financave publike. Jacek Jezierski, ish-President i Zyrës Supreme të Auditimit. Fjala e mbajtur në séance plenare të Sejm-it.

“Ne kemi ndryshuar strukturën e departamenteve në zyrën qendrore, duke krijuar departamente të reja pak më të vogla se më parë, të cilat - si rezultat - janë në gjendje të mbulojnë më shumë fusha me aktivitetin e tyre të auditimit dhe të përshtaten më mirë me objektivin kryesor, që është auditimi i marrëdhënies midis autoriteteve dhe qytetarit, dhe në një masë më të vogël mes autoriteteve - ky është një ndryshim i madh kur bëhet fjalë për qasjen ndaj auditimit, planifikimit të auditimit, ky është një ndryshim që i sjell këto auditime më afër qytetarit, në përputhje me kërkesat dhe pritshmerite të qytetarëve”. Jacek Jezierski, ish-President i Zyrës Supreme të Auditimit, fragment nga fjala perpara Komisionit të Ligjeve dhe Komisionit të Gjetjeve dhe Rekomandimeve të Auditimit Suprem të Sejm-it

Gjate periudhës 2007-2013 të mandatit të Presidentit Jacek Jezierski, NIK zgjeroi në mënyrë të ndjeshme marrëdhëniet e bashkepunimit me SAI-t partnere si në Evropë dhe me gjere. Por, nuk mund të ketë shembull më të mirë të një marrëdhënieje ndërinstitucionale, që është iniciuar dhe konsoliduar nga vullneti, dëshira dhe gatishmëria personale e z.Jezierski sesa ajo mes NIK-it Polak dhe KLSH-së, të cilat ndonëse kishin nisur pas viteve 90, e që u formalizuan pas viteve 2000, mbeten thjesht në letra.

Ishte pikërisht ky angazhim personal i Jacek Jezierskit që bëri të mundur rinovimin e marrëveshjes mes KLSH-së dhe NIK-ut, kur si Kryetar i KLSH-së pata nderin që në qershor të vitit 2012, të vizitoja Poloninë falë mbështetjes vendimtare të Presidentit të NIK Jacek Jezierski.

Fill pas një jave nga nënshkrimi i marrëveshjes, falë përkushtimit dhe këmbënguljes së President Jezierski, ekipi i parë i audituesve të KLSH prej 15 audituesish do të vizitonte NIK-un për tu trajnuar nga specialistet e NIK në qendren e trajnimeve Golawic në Varshavë. Ky trajnim i parë kurorëzoi fillimin e një tradite dinamikë të shkëmbimit të vizitave trajnuese kur periudhës 2012-2016, një numër i konsiderueshem audituesish shqiptarë trajnohet në mjediset e NIK për auditimet e performancës, financiare, të përputhshmerisë dhe të teknologjisë së informacionit.

Çka është vlerë është se në marrëdhëniet me KLSH-në, z.Jezierski ka reflektuar në plotësi miqësinë dhe afeksinë e madh që shteti dhe populli polak ndan për Shqipërinë dhe shqiptarët. Sot mund të themi pa mëdyshje se Jacek Jezierski është një mik i madh jo vetëm i KLSH-së, por një mik i madh i Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Efektiviteti i NIK. Krzysztof Kwiatkowski (2013-2019)⁹

“Dhenja parlamentit dhe publikut të informacionit të besueshëm, si për parregullsitë ashtu edhe për praktikën e mira, ka për qëllim të forcojë llogaridhënien publike dhe në këtë mënyrë të forcojë ndjenjën e përgjegjësisë së autoritetit publik dhe administratës së tij ndaj shoqërisë” Krzysztof Kwiatkowski, President i NIK, 2013, fjala perpara Sejm-it në emerimin e tij.

⁹ Mbështetur në botimin jubilar të NIK në anglisht “1919-2019: Zyra Supreme e Auditimit-Një shekull i NIK në shërbim të Shtetit Polak”, Varshavë, 2019.

Menjëherë pasi u betua, më 27 gusht 2013, Presidenti i sapoemëruar i Zyrës Supreme të Auditimit, Krzysztof Kwiatkowski, theksoi se auditimet nën drejtimin e tij do të përqëndroheshin në problemet më të rëndësishme të Shtetit, veçanërisht në ato fusha që përfshijnë rrezikun më të madh sistemik.

Gjatë mandatit të Presidentit Kwiatkowski, Zyra Supreme e Auditimit filloi të trajtonte në një masë më të madhe çështje me interes për qytetarët. Për sa i përket fushës së rëndësishme të mbrojtjes shëndetësore, u kryen teste të thelluara të auditimit, duke përfshirë fusha të tilla si: tregu i shtesave ushqimore dhe ilaçeve, kualiteti i kujdesit mjekësor për të moshuarit, mbrojtja e shëndetit mendor, ushqimi i pacientëve në spitale, disponueshmëria dhe financimi i diagnostikimit laboratorik, parandalimi i problemeve me shëndetin në sistemin e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë zbulimin e hershëm të kancerit.

Në vitet e fundit, NIK është bërë më i hapur për bashkëpunim me institucione të ndryshme dhe me shoqërinë civile, si me qeverisjen vendore, qarqet akademike, shoqatat e avokatëve vetëqeverisës, organizatat e sipërmarrësve dhe organizatat joqeveritare. Këta NIK i konsideron partnerë të rëndësishëm në përpjekjet e Zyrës Supreme të Auditimit për të përmirësuar shtetin.

Si një partner profesional dhe i besueshëm, NIK u perfshi në shumë projekte ndërkombëtare gjate periudhes 2013-2019, si, p.sh. në projektet e binjakëzimit që synojnë forcimin dhe zhvillimin e institucioneve të auditimit suprem të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale në Bashkimin Evropian.

Zyra Supreme e Auditimit gjithashtu u bë audituesi i Korpusit Shumëkombësh të Verilindjes së NATO-s, i cili është me rëndësi kyçe për sigurinë e Polonisë dhe gjithë rajonit të kësaj pjese të Evropës. Besimi në funksionin e audituesit të Korpusit ishte një shprehje e besimit si në profesionalizmin dhe në njohjen nga NIK të çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen kombëtare.

Në vitin 2018, Zyres iu besua një tjetër auditim ndërkombëtar - auditimi i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) me seli në Paris, i cili bashkon 36 vende demokratike shumë të zhvilluara nga e gjithë bota.

Në 30 gusht 2019, z.Marin Banas u emërua President i Zyrës Supreme të Auditimit të NIK. Me këtë rast, dëshiroj të shpreh Presidentit Banas urimet e mia më të përzemërta dhe suksese në marrjen e detyrës së re duke shprehur njëkohësisht dëshirën që marrëdhëniet mes KLSH-së dhe NIK-ut të vazhdojnë të njëjtë traditë të partneritetit reciprok sikurse kanë njohur me z.Jeziński dhe z. Kwiatkowski.

V. Zyra Supreme e Auditimit

Funksionimi i shtetit modern kërkon një sërë organesh, shpesh duke kapërcyer formulën tradicionale të ndarjes terciale të pushteteve. Kapitulli IX i Kushtetutës së Republikës së Polonisë të 2 prillit 1997 përcakton profilin kushtetues të tre organeve: Zyrës Supreme të Auditimit, Komisionerit për të Drejtat e Njeriut dhe Këshillit Kombëtar të Transmetimeve. Ato mund të përkufizohen si organeve të kontrollit dhe mbrojtjes ligjore ose organe të pushtetit të katër, pra të pushtetit mbikëqyrës.

Për mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të qeverisë, Parlamenti nuk ka në dispozicionin e vet një aparat të posaçëm për kryerjen e kontroleve profesionale. Prandaj, organet që asistojnë Parlamentin në kryerjen e funksionit të tij monitoruese janë të caktuar me ligj. Sipas rastit, këto janë organe të pavarura të natyrës së gjykatës (p.sh. Gjykata e Auditimit të Francës).

Në Poloni, që nga periudha e luftës ka pasur një model tjetër funksionues të organit të auditimit shtetëror, të lidhur me Parlamentin. Është Zyra Supreme e Auditimit. Mandati i Zyrës Supreme të Auditimit përcaktohet në nenin 202 të Kushtetutës. Zyra Supreme e Auditimit është organi kryesor i auditimit shtetëror, që i nënshtrohet Sejmit dhe vepron në përputhje me parimet e kolegjalitetit. Nuk konsiderohet si pjesë e legjislativit apo ndonjë pushteti tjetër, por si pushtet me vete sikurse përcaktohet nga Kushtetuta dhe nga fakti se Kapitulli IX titullohet Organet e Kontrollit Shtetëror dhe

të Mbrojtjes së Të Drejtave, ndërsa kapituajt e tjerë përcaktojnë detyrat e pushteteve legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

Kësisoj, ligjvënësi thekson pavarësinë e Zyrës Supreme të Auditimit si një organ të përqendruar plotësisht në auditimin shtetëror dhe ekzaminimin e aktiviteteve të organeve publike. Zyra Supreme e Auditimit i nënshtrohet vetëm Sejmit.

Sejmi mund të bëjë kërkesë për kryerjen e një auditimi dhe nga ana tjetër NIK i ofron Sejmit informacion mbi rezultatet e auditimit dhe një raport vjetor mbi aktivitetin e tij.

Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë drejtohet nga Presidenti, i emëruar nga Sejmi, me pëlqimin e Senatit. Sipas dispozitave ligjore, Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit zgjidhet me kërkesën e Kryetarit i të Sejm-it apo të një grup prej të paktën 35 deputetësh. Sejmi miraton një rezolute mbi caktimin e Presidentit të NIK me shumicë absolute votash. Senati jep pëlqimin për emërimin brenda 30 ditësh nga data e marrjes së rezolutës së Sejmit ose refuzon dhënien e pëlqimit. Nëse brenda kësaj periudhe, Senati nuk jep pëlqimin, miratimi i tij quhet i prezumuar. Nëse Senati e refuzon miratimin e emërimit të Presidentit të NIK-ut, Sejmi cakton një tjetër emër. Mandati i Presidentit të NIK-ut është 6 vjeçar. Pas përfundimit të mandatit, Presidenti vazhdon detyrën deri në zgjedhjen e presidentit të ri. I njëjti person mund të zgjidhet President por jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

Përveç Presidentit, një tjetër organ administrativ i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë është Këshilli. Këshilli i NIK-ut përbehet nga Presidenti, zv/presidentët, Drejtori i Përgjithshëm dhe 14 anëtarët e këshillit.

Detyrat e Këshillit të NIK-ut përfshijnë vlerësimin e analizës së zbatimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet mbi politikat monetare. Për të shtuar, Këshilli miraton opinion mbi miratimin e buxhetit për Këshillin e Ministrave dhe jep rekomandime mbi probleme të veçanta të theksuara nga Sejmi në lidhje me detyrat e ushtruara nga institucionet publike.

Zyra Supreme e Auditimit kryen aktivitete audituese të organeve të administratës publike, Bankës Kombëtare të Polonisë, personave juridikë shtetëror dhe njësisve të tjerë të shtetit në lidhje me përputhshmërinë me ligjet, eficiencën ekonomike, efektivitetin (përdorimin e mjeteve të duhura për të arritur qëllimet e synuara) integritetin (marrjen e masave në përputhje me gjendjen e konstatuar).

Zyra Supreme e Auditimit kontrollon zbatimin e buxhetit, kryerjen e detyrave të auditimit të brendshëm, financat dhe asetet e Kancelarit të Sejmit, Kancelarit të Senatit, Kancelarit të Presidentit të Republikës së Polonisë, Gjykatën Supreme, Gjykatën Supreme Administrative, Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit, Tribunalin Kushtetues, Komisionerin për të Drejtat e Fëmijëve, Këshillin Kombëtar të Transmetimeve, Inspektorin e Përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave, Komisionin për Krimet kundër Kombit Polak, Zyrën Kombëtare të Zgjedhjeve dhe Inspektoratin Kombëtar të Punës.


Lidhur me njësitë organizative të Zyrës Supreme të Auditimit, në to përfshihen departamentet, zyrat dhe degët rajonale.

Njësitë e Organizimit të NIK Organisational Units

Organizimi i brendshëm i Zyrës Supreme të Auditimit përcaktohet me Ligjin për NIK. Dy lloje njësisish funksionojnë brenda NIK - njësitë e auditimit dhe njësitë e administrimit dhe mbështetjes. Sipas Statutit të NIK-ut që përcakton organizatën e brendshme të Zyrës Supreme të Auditimit, 30 njësi auditimi funksionojnë brenda Zyrës, që përbëhen nga 14 departamente dhe 16 Degë Rajonale.

Statuti i NIK përcakton territoret operative të Degave të veçanta Rajonale, të cilat korrespondojnë me ndarjet administrative (rajone) të Polonisë. Detyrat administrative dhe ndihmëse të NIK-ut kryhen nga katër departamente. Ata merren me çështje administrative, prokurim publik, llogari financiare të NIK-ut, menaxhim të pasurive, burimeve njerëzore, transport, IT dhe buxhet, ndër të tjera.¹⁰

¹⁰ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 11.



11

Personeli¹²

Në 2018, NIK regjistroi 1601 punonjës. Audituesit janë njerëz me eksperiencë të gjatë dhe moshë mbi 48 vjeç. Mes të diplomuarve në universitete, 60 individë kanë titullin akademik të Doktorit të Shkencave dhe 48 janë të diplomuar nga Shkolla Kombëtare e Administratës Publike.

Si një nga të paktat Zyra Supreme të Auditimit të Europës, NIK-u zhvillon trajnime të vazhdueshme për audituesit e rinj. Trajnimet përfshijnë teorinë dhe praktikën.

NIK forcon rolin mbikëqyrës të Sejm-it

Në 2018, NIK ka përcjellë 191 raporte auditime në Sejm-in polak. Raportet dhe konkluzionet e NIK synojnë mes të tjerash të mbështesin autoritetet shtetërore në procesin ligjvënës, por edhe në zhdukjen e parregullsive dhe kërcënimeve të aktiviteteve të tyre.

Mes dokumenteve kryesore që NIK është i detyruar t'i përcjellë Sejm-it, një nga më të rëndësishmit është raporti vjetor për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe zbatimin e objektivave të politikës monetare, si dhe dhënien e opinionit miratues për Këshillin e Ministrave.

¹¹ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 12.

¹² NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 13.

Sejmi bazohet në opinionin e dhënë nga Zyra Supreme e Auditimit në ushtrimin e funksionit të saj mbikëqyrës – në rast të debatit vjetor mbi zbatimin e buxhetit nga qeveria, në varësi të vlerësimit nga NIK, qeverisë i akordohet ose jo miratimi i buxhetit¹³.

Si ndikon NIK në përmirësimet ligjore

Në kryerjen e auditimeve, NIK analizon praktikat negative në institucionet e audituara, por shkon përtej. Vizioni i NIK-ut “ne ndihmojmë përmirësimin e shtetit” manifestohet në propozimet për ndryshime ligjore (kryerjen e amendamenteve nëse konstatohen boshllëqe apo ka paqartësi)¹⁴.

Aktivitetet audituese të NIK-ut¹⁵

Zyra Supreme Audituese e Polonisë shqyrton të gjithë fushat e aktiviteteve shtetërore në lidhje me fondet dhe asetet publike. Po ashtu, verifikon nëse institucionet i kanë kryer detyrat me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiensë.

- **Auditimi i Buxhetit të Shtetit**

Auditimi i buxhetit të shtetit i përket funksionit bazë të NIK-ut. Kjo detyrë është gjithmonë në krye të planit të punës audituese. Auditimi i buxhetit koordinohet nga Departamenti i Buxhetit dhe Financës dhe përfshin të gjitha njësitë audituese të NIK-ut.

- **Planifikimi i auditimit**

Planifikimi i auditimit në Zyrën Supreme të Auditimit është një nga hapat e rëndësishme në procesin auditues. Sipas Ligjit të 23 dhjetor 1994, NIK-u ushtron funksionet e tij bazuar në një plan vjetor i cili miratohet nga Këshilli i NIK-ut e më pas përcillet në Sejm.

Planifikimi i auditimit ndihmon në reduktimin e kostove audituese. Të gjithë punonjësit e NIK kanë të drejtë të propozojnë subjekte auditimi. Përgjatë hartimit të planit vjetor 2018, punonjësit e NIK sugjeruan mbi 400 subjekte audituese në organet e Sejm-it, Senatit, Kryeministrisë etj, -në total 131 propozime¹⁶.

- **Auditimet Ad-hoc**

Përpos auditimeve të planifikuara, NIK realizon edhe auditime të veçanta ose ad-hoc kur ka çështje të rëndësishme të veçantë që kërkon verifikim. Këto auditime dalin edhe nga ankesat që vijnë në NIK. Në 2018, NIK realizoi 91 auditime ad-hoc në 195 subjekte.

- **Deklarata post-auditim**

Një dokument pune që hartohet pas përfundimit të një auditimi është deklarata post-auditim, e cila i adresohet drejtuesit të subjektit të audituar, duke i prezantuar gjetjet dhe rekomandimet.

- **Rekomandimet e auditimit**

NIK nuk identifikon thjesht praktikat e këqija, por edhe propozon zgjidhje për eliminimin e parregullsive në të ardhmen. Disa rekomandime implementohen gjatë ushtrimit të auditimit.

- **Raporti i Auditimit**

NIK përgatit raporte të cilat përmbledhin të gjitha veprimet audituese, gjetjet dhe rekomandimet. Raportet botohen rregullisht në faqen web të NIK dhe aksesohen lirisht nga qytetarët. Në 2018, NIK dorëzoi 191 raporte auditime në Sejm.

¹³ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, pg. 15.

¹⁴ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, pg. 19.

¹⁵ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 20-22.

¹⁶ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 17.

VI. Si punon NIK – njësitë audituese¹⁷

- **Departamentet e NIK-ut**

Departamentet realizojnë dhe mbështesin proceset audituese në subjektet e niveleve të larta dhe qendrore brenda kornizës së kompetencave të tyre, në përputhje me ligjin e NIK-ut, dhe mund të auditojnë institucionet vendore në koordinim me degët rajonale përkatëse të NIK-ut.

Departamentet e auditimit koordinojnë auditime ose marrin pjesë në procedurat audituese, në veçanti në përgatitjen e auditimit, ekzaminimin e observacioneve dhe përgatitjen e informacionit mbi rezultatet e auditimit ose dokumente të tjera.

Departamentet përkatëse janë të ngarkuara edhe me detyrën e realizimit të auditimeve mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, për çështjet që i përkasin sferës së kompetencave të tyre. Njësitë organizative audituese po ashtu marrin pjesë në kryerjen e auditimeve që bëhen në territorin e Republikës së Polonisë nga Gjykata Europiane e Audituesve.

NIK-u përbëhet nga 14 Departamente të vendosura në godinën e NIK-ut në Varshavë.

- **Departamenti i Administratës Publike**

Departamenti i Administratës Publike luan një rol kryesor në auditimin e performancës së administratës publike, si nga perspektiva e të gjithë qeverisë ashtu edhe nga interesat e qytetarëve të veçantë. Departamenti i Administratës Publike kryen auditime kryesisht mbi aktivitetin e administratës publike dhe mbi çështjet e institucioneve individuale të administratës qeveritare.

Një sferë e rëndësishme audituese janë çështjet që lidhen me anëtarësinë e Polonisë në Bashkimin Europian, përfshirë shpenzimet nga buxheti i BE-së. Departamenti i Administratës Publike po ashtu merret me çështjet e zhvillimit rajonal, mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve etnike, informatizimin, çështjet e jashtme si dhe aktivitetet e Zyrës Qendrore të Statistikave dhe Zyrës së Prokurimeve Publike. Përgjegjësitë e departamentit përfshijnë auditimin e brendshëm, menaxhimin financiar dhe të pronës në Gjykatën e Lartë Administrative dhe Tribunalin Kushtetues.

- **Departamenti i Buxhetit dhe Financës**

Sipas nenit 204/1 të Kushtetutës së Republikës së Polonisë, Zyra Supreme e Auditimit luan një rol të veçantë në miratimin e raportit mbi zbatimin e buxhetit nga Sejmi (Dhoma e Ulët e Parlamentit), për shkak se realizon 100 auditime mbi zbatimin e buxhetit kombëtar për secilën pjesë të tij dhe i ofron Sejmit një analizë mbi ekzekutimin e buxhetit, udhëzime mbi politikat monetare dhe një opinion mbi votimin e miratimit nga Këshilli i Ministrave. Departamenti i Buxhetit dhe Financës koordinon aktivitetet e NIK-ut në këto fusha.

- **Departamenti i Ekonomisë, Aseteve Publike dhe Privatizimit**

Departamenti i Ekonomisë, Aseteve Publike dhe Privatizimit mbulon ekonominë e përgjithshme kombëtare, zhvillimin e saj, menaxhimin e asetëve publike dhe kalimet e pronësisë. Ky departament ka kompetencën për të kryer auditime mbi çështjet e ekonomisë, energjisë dhe menaxhimit të depozitave minerale. Përpos kësaj, përgjegjësitë e Departamentit përfshijnë auditimin e të ardhurave nga privatizimi i asetëve publike, të aktivitetëve të Zyrës së Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Komitetin Polak të Standardizimit, Agjencinë e Rezervave Materiale, Agjencinë Polake

¹⁷ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 36-50.

për Zhvillimin e Sipërmarrjes, Agjencinë e Zhvillimit Industrial, Fondin e Riprivatizimit, Fondin e Ristrukturimit të Sipërmarrjes dhe Fondin e Kompensimit.

- **Departamenti i Infrastrukturës**

Infrastruktura është një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin kombëtar. Përmirësimi i infrastrukturës polake të transportit, energjisë dhe komunikimit është esencial për rritjen e ekonomisë polake. Cilësia e duhur e kësaj infrastrukturë ka po ashtu rëndësi madhore për cilësinë e jetës dhe për sigurinë publike.

Departamenti i Infrastrukturës kryen auditime mbi industrinë detare, transportimin, komunikimin, industrinë e ndërtimit, menaxhimin urbanistik dhe të banesave. Përgjegjësitë e Departamentit përfshijnë auditimin e zbatimit të planeve financiare të fondit për Menaxhimin e të Dhënave e Gjeodezisë dhe Hartografisë.

- **Departamenti i Metodologjisë së Auditimit dhe Zhvillimit Profesional**

Departamenti i Metodologjisë së Auditimit dhe Zhvillimit Profesional është përgjegjës për zhvillimin dhe përmirësimin e metodologjisë audituese duke përdorur eksperiencat e brendshme dhe praktikatat e adoptuara nga Institucionet Supreme të Auditimit në vende të tjera. Promovimi i dijes nga standardet ndërkombëtare si manualët audituese, zbatimi i standardeve ndërkombëtare nga NIK, mbështetja e procesit të NIK-ut në auditimin dhe analizimin e cilësisë së auditimeve dhe në mbështetjen e njësisë audituese në përdorimin e burimeve dhe mjeteve IT për qëllime audituese janë detyrat kryesore të këtij Departamenti. Përmirësimi i metodologjisë audituese fokusohet në cilësinë përgjatë çdo faze të procesit auditues, përfshirë cilësinë e raportit auditues si produkti kryesor i aktiviteteve të NIK-ut.

- **Departamenti i Shkencës, Edukimit dhe Trashëgimisë Kombëtare**

Mandati i Departamentit të Shkencës, Edukimit dhe Trashëgimisë Kombëtare mbulon një spektër të gjerë çështjesh të lidhura me edukimin e fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimin e shkencës dhe arsimit të lartë si dhe me tematikat kulturore, mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, edukimit fizik, sportit dhe turizmit. Çështjet e audituara nga Departamenti i Shkencës, Edukimit dhe Trashëgimisë Kombëtare i përkasin kompetencave të katër ministrive: Ministrisë së Edukimit Kombëtar; Ministrisë së Shkencës dhe Arsimit të Lartë; Ministrisë së Kulturës dhe Trashëgimisë Kombëtare ; dhe Ministrisë së Sportit dhe Turizmit.

- **Departamenti i Mbrojtjes Kombëtare**

Forcat e Armatosura të Republikës së Polonisë dhe gatishmëria e tyre e vazhdueshme për mbrojtjen e kufijve polakë, politikat e mbrojtjes dhe sigurisë, angazhimet e Polonisë në kuadër të aleancës së NATO-s, masat e marra për mbrojtjen e Polonisë dhe çështjet e sigurisë së jashtme dhe të brendshme – të gjithë këto janë pjesë e politikave të mbrojtjes së Polonisë, të cilat auditohen nga Departamenti i Mbrojtjes Kombëtare.

- **Departamenti i Rendit Publik dhe Sigurisë së Brendshme**

Siguria, në të gjitha aspektet e saj kombëtare dhe individuale, është një nga pjesët më të rëndësishme të politikave qeveritare. Zyra Supreme e Auditimit luan një rol të rëndësishëm në monitorimin e problemeve të lidhura me këtë sferë të aktivitetit publik. Mandati i Departamentit të Rendit Publik dhe Sigurisë së Brendshme përfshin auditime në fushat e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme,

aktivitetin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorët e varësisë, Agjencinë e Sigurisë së Brendshme, Agjencinë e Shërbimit Informativ të Jashtëm dhe Byronë Qendrore të Antikorrupsionit

- **Departamenti i Punës, Çështjeve Sociale dhe Familjes**

Departamenti i Punës, Çështjeve Sociale dhe Familjes është përgjegjës për kryerjen e auditimeve në fushat si: punësimi, sigurimet shoqërore, familjes, personat me aftësi të kufizuar, veteranët dhe viktimat e represionit. Përgjegjësitë e Departamentit përfshijnë po ashtu auditimin e zbatimit të planeve financiare të: Fondit të Sigurimeve Shoqërore, Fondit Shtetëror të Personave Invalidë, Fondin e Pensioneve, Fondin për Parandalimin dhe Rehabilitimin, fondin administrativ, Fondin e Punës, si dhe performancën e detyrave të kryera nga auditimi i brendshëm, menaxhimin financiar dhe të pronave nga Inspektorati Kombëtar i Punës dhe Komisioneri i Fëmijëve.

- **Departamenti i Çështjeve Ligjore**

Departamenti i Çështjeve Ligjore është një zyrë mbështetëse ligjore në NIK, ku janë të punësuar juristë me kualifikime të lartë profesionale.

Mandati i Departamentit të Çështjeve Ligjore përfshin ofrimin dhe koordinimin e shërbimeve ligjore gjatë procedimeve audituese, procesin e kundërshtive të referuara tek Komiteti i Rezolutave dhe Këshillit të NIK-ut, koordinimin e çështjeve të lidhura me bashkëpunimin e NIK-ut me institucionet ligjzbatuese, koordinimin e bashkëpunimit të NIK-ut me Parlamentin, Senatin dhe organet e tyre të brendshme si dhe me institucionet e tjera qeveritare për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe propozimet ligjore.

- **Departamenti i Agrikulturës dhe Zhvillimit Rural**

Departamenti i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është i mandatuar të auditojë çështje në lidhje me zhvillimin e Bujqësisë dhe atij rural, kryerjen e auditimeve të performancës mbi detyrat e ushtruara nga këto organe, përfshirë ministrinë përgjegjëse për: Bujqësinë, zhvillimin rural, peshkimin si dhe zbatimin e buxhetit në këto sfera. Detyrat e këtij departamenti mbulojnë po ashtu aktivitetet e Agjencisë e Aseteve Agrokulturore, Agjencinë e Ristrukturimit dhe Modernizimit e Bujqësisë, Agjencinë e Tregut Agrokulturore dhe Qendrën e Kërkimit për Testimin e Kultivimeve.

- **Departamenti i Strategjisë**

Departamenti i Strategjisë luan një rol të rëndësishëm në aktivitetet audituese të Zyrës Supreme të Auditimit, në veçanti në lidhje me zhvillimin e strategjive audituese të NIK, zhvillimin e programeve vjetore dhe koordinimin e zbatimit të tyre.

Mandati i Departamentit përfshin po ashtu koordinimin dhe zbatimin e raportimit të brendshëm dhe përgatitjen e raporteve të aktivitetit të NIK-ut, veçanërisht raportin e aktivitetit vjetor. Gjithashtu, detyrat e saj përfshijnë dhënien e mendimeve për hartimin e programeve të punës dhe raporteve të auditimit, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me këto programe, dhënien e mendimit mbi dokumentet post-auditim të firmosura nga Presidenti i NIK-ut, dhënien e mendimit mbi kryerjen e auditimeve *ad hoc* (me kërkesë të Presidentit të NIK-ut). Mbi të gjitha, ky departament është i mandatuar të analizojë aktivitetin e njëjësive organizative dhe detyrat lidhur me kontrollin e brendshme, në përputhje me parimin e raportimit të drejtpërdrejt të Audituesit të Brendshëm tek Presidenti i NIK-ut.

- **Departamenti i Mjedisit**

Zyra Supreme e Auditimit luan një rol të veçantë për mbrojtjen e mjedisit dhe mbulon një spektër të gjerë tematikash në lidhje me mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve mjedisore, ajrit, ujit, gjësë së gjallë dhe depozitave minerare - të cilat janë subjekt i auditimit të NIK-ut.

Mandati i Departamentit të Mjedisit përfshin auditimin e çështjeve lidhura kryesisht me menaxhimin e burimeve ujore dhe mjedisin. Departamenti po ashtu auditon zbatimin e planeve financiare për Fondin Kombëtar të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Menaxhimin e Ujit.

- **Departamenti i Shëndetësisë**

Problemet në lidhje me mbrojtjen e shëndetit, cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve mjekësore në Poloni përbëjnë një rëndësi madhore për fokusin e auditimeve të NIK. Departamenti i Shëndetësisë auditon përpos të tjerash çështjen në lidhje me parandalimin e sëmundjeve dhe mbrojtjen shëndetësore nga njësitë e sistemit shëndetësor, administrimin dhe menaxhimin e spitaleve dhe qendrave shëndetësore në nivele të ndryshme, zbatimin e politikave shëndetësore dhe përmirësimin e nivelit shëndetësor të popullatës në Poloni.

Mandati i Departamentit të Shëndetësisë përfshin edhe auditime mbi zbatimin e planeve financiare të Fondit Shëndetësor dhe shpenzimeve buxhetore në këtë fushë si dhe të Avokatit të Drejtave të Pacientëve.

Degët Rajonale të NIK-ut¹⁸

Degët rajonale kryejnë auditime në autoritetet rajonale që janë nën juridiksionin e tyre – që korrespondon me ndarjen administrative të vendit në rajone. Në koordinim me departamente qendrore, ato mund të zhvillojnë dhe procedura auditimi në autoritetet e larta të pushtetit qendror, sikundër dhe auditime të koordinuara. Struktura organizative e NIK-ut ka 16 degë rajonale, ku më të rëndësishmet renditen si më poshtë:



¹⁸ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 51-67.

- **Dega Rajonale e NIK-ut në Bydgoszcz**

Territori i aktivitetit të Degës Rajonale të NIK-ut në Bydgoszcz shtrihet në rajonin Kujawsko-Pomorskie. Qendra të mëdha të populluara në këtë rajon përfshijnë Bydgoszcz në Lumin Vistula dhe Toruh, qyteti i lindjes së Nikola Kopernikut. Toruh është një nga qytetet më të vjetra të Polonisë, ndërtesat historike të të cilit janë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Pjesa historike e Bydgoszcz, që ndodhet në Lumin Brda, sëbashku me ndërtesat e tij që ngrihen në brigjet e lumit shpeshherë quhet "Amsterdami polak" ose "Venecia polake". Të dyja qytetet janë qendra të rëndësishme të shkencës dhe kulturës.

Ky rajon shquhet për një bujqësi të zhvilluar e cila është kthyer në bazë për projektet investuese në industrinë e ushqimit. Përpos kësaj, për shkak të traditave të tij industriale dhe të arsimit të specializuar, rajoni njihet si një vend tërheqës për facilitetet industriale.

Zyrat dhe institucionet rajonale ndodhen në dy qendra kryesore urbane - Bydgoszcz është selia e institucioneve rajonale të pushtetit qendror, ndërsa Toruh është selia e autoriteteve të pushtetit vendor të Rajonit Kujawsko-Pomorskie.

- **Dega Rajonale e NIK-ut në Gdansk**

Gdansk është një qytet-porti me tradita Hanseatic-e dhe histori multikulturorë që daton më shumë se një mijë vjet përpara. Greva industriale në kantierin e Gdansk në Gusht 1980 dhe themelimi i Sindikatës së Pavarur Vetëqeverisëse "Solidarnos" shënoi rënien e sistemit komunist në Evropën Qendrore dhe Lindore. Suksesi i Solidarnos-it dhe fitores elektorale të opozitës në Poloni në qershor 1989 dha një shtysë për lëvizjet antikomuniste në vendet e tjera të bllokut komunist në Evropë. Në vjeshtën e vitit 1989, pati protesta masive në Çekosllovakia, Hungari, Bullgari, Rumani, Shqipëri dhe në Republikën Demokratike Gjermane të udhëhequr nga komunistët (Gjermania Lindore). Kjo trazirë arriti kulmin me rënien e Murit të Berlinit në nëntor 1989. Ngjarjet që shpërthyen në Gdansk çuan përfundimisht në shpërbërjen e "Urdhrit të Jaltës" i cili kishte ndarë kontinentin për gjysmë shekulli në bllokun e vendeve komuniste dhe atë të vendeve të lira të Evropa Perëndimore.

Në vitin 2018, Dega Rajonale në Gdansk koordinoi auditimet: *Politikat ujore në ujërat e detit dhe në zonën bregdetare; Menaxhimi i pasurive të Universitetit Detar në Gdynia dhe Szczecin; Zhvillimi i porteve të mesme dhe të vogla; Funkcionimi i buxheteve pjesëmarrëse; Implementimi i programit "Rodzina 500+" ("Familja 500+").*

- **Dega Rajonale e NIK-ut në Krakow**

Dega Rajonale e NIK-ut në Krakow mbulon zonën e Rajonit Matopolskie të vendosur në kufirin jugor të Polonisë. Krakow është qendra kryesore urbane e rajonit të Polonisë së Ulët (Latinisht: Polonia Minore) dhe dikur ishte kryeqyteti i Polonisë deri në fund të shekullit XVI. Kalaja dhe katedralja Wawel kanë mbetur një qendër simbolike e shtetit të Polonisë deri në ditët e sotme. Krakow është një qendër shkencore, me Universitetin e saj Jagiellonian - universiteti më i vjetër në këtë pjesë të Evropës, i themeluar në 1364, dhe një qendër biznesi e rajonit. Polonia e Ulët nënkupton tradita të pasura, monumente historike dhe natyrë unike. Malet Tatra në jug janë i vetmi vargmal alpin në Poloni. Polonia e Ulët i përket destinacioneve më tërheqëse të vizitorëve në Poloni.

Në vitin 2018, Dega Rajonale në Krakow koordinoi auditimet: *Mbrojtja e ajrit nga ndotja; Pajtueshmëria me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në menaxhimin e burimeve ujore në komunat turistike; Zbatimi i Dosjes Standarde të Auditimit për Taksat gjatë procedurave tatimore dhe auditimeve; Auditimi dhe efiçienca e procedurave përmbartimore të kryera nga autoritetet e mbikëqyrjes së ndërtimeve.*

- **Dega Rajonale e NIK-ut në Łódź**

Łódź është një qytet me tradita të pasura, të quajtura qyteti i katër kulturave -Hebre, Polake, Ruse dhe Gjermane. Në shekullin XIX, qyteti me rrethinë ishte qendra më e madhe e industrisë së tekstit në

këtë pjesë të Evropës. Sot, rëndësia parësore e këtij vendi dëshmohet nga monumentet kulturore industriale të shekullit XIX dhe ndërtesat mbresëlënëse historike në qendër të qytetit me shtëpitë e banimit dhe pallatet e pronarëve të fabrikave të Łódź. Sot, Łódź është një qendër e rëndësishme shkencore dhe kulturore, vendi, ndër të tjera, i Shkollës së Filmit Łódź, e themeluar nga regjisorët e filmit si Andrzej Wajda, Janusz Morgenstern dhe Roman Polański . Për shkak të vendndodhjes qendrore, Łódź është një qendër e rëndësishme e transportit. Miniera më e madhe e qymyrit kaf në Evropë është e vendosur në Betchatow. Në vitin 2018, Dega Rajonale në Łódź koordinoi auditimet: Mbikëqyrja mbi aplikimin e aditivëve ushqimorë; Parandalimi i bllokimeve të trafikut në rrugët nacionale; Parandalimi i bllokimeve të trafikut në Łódź; Termoizolimi i ndërtesave të banesave shumë-familjare si pronë e kooperativave të strehimit, i zbatuar me pjesëmarrjen e fondeve publike.

Në të kaluarën, Dega Rajonale ka zhvilluar gjithashtu auditime të rëndësishme për rajonin, siç janë: *Mbrojtja e qytetarëve nga zhurma e shkaktuar nga trafiku tranzit në autostradën S-8 dhe A-1; Investimet e financuara publike të kooperativave të strehimit; Operimi dhe zbatimi i detyrave të zgjedhura statutores të Qendrës Rajonale të Dhurimit dhe Trajtimit të Gjakut në Łódź.*

- **Dega Rajonale në Poznań**

Poznań është kryeqyteti i Wielkopolska-s (Polonia e Lartme, Latinisht: Polonia Maior) - një rajon që ka qenë veçanërisht i rëndësishëm në aspektin historik, si dhe në ditët e sotme. Qendrat e hershme të epokës së mesme - Poznań, Gniezno ose Lednica - përbënin djepin e shtetit polak në mesin e shekullit X. Tani, Poznań dhe gjithë Polonia e Madhe përbëjnë një nga qendrat kryesore ekonomike dhe kulturore. Zhvillimi ekonomik i rajonit është efekt, ndër të tjera, i kapitalit njerëzor vendas, lidhjeve të mira të transportit, mjedisit të biznesit të zhvilluar mirë dhe traditave të kulturës industriale dhe tregtare. Panairi Ndërkombëtar i Poznań-it është një nga ekspozitat më të bukura të rajonit.

Dega Rajonale e NIK-ut në Poznań ka kryer disa auditime në lidhje me çështjet sociale dhe ekonominë e rajonit, duke përfshirë, ndër të tjera, *zbatimin e "Programit të Zhvillimit të Infrastrukturës Rrugore Komonale dhe Qarkut për 2016-2019", financimin e Brigadave Vullnetare të Zjarrit, funksionimin e Menaxhimit të Mbeturinave të Bashkimit Ndër-Komunal të Aglomeratit të Poznańit, Regjistrimin dhe dëshminë e personave për qëllime të kualifikimit ushtarak.* Dega Rajonale ka ekzaminuar edhe pikat sociale dhe mjedisore, siç janë *programi i medikamenteve falas për pleqërinë LEK1 75+ dhe funksionimi i farmacive spitalore dhe njësisve farmaceutike spitalore.*

- **Dega Rajonale e NIK-ut në Varshavë**

Dega Rajonale në Varshavë është një nga njësitë më të mëdha organizative të NIK-ut polak për sa i përket punësimit. Territori i saj i veprimtarisë përfshin rajonin Mazovian në qendër të vendit - rajoni më i madh dhe më i pasur në Poloni. Varshava është qendra e jetës politike, sociale dhe ekonomike. Sektorët kryesorë të ekonomisë Mazoviane janë shumë të larmishme, gjë që e bën atë më pak të prekshëm nga ciklet e biznesit në tregjet e vendit dhe ato ndërkombëtare. Qarku Mazovian karakterizohet gjithashtu nga vëllimet më të mëdha të eksportit dhe importit në Poloni.

Për shkak të vendndodhjes në kryeqytet, Dega Rajonale e NIK-ut në Varshavë shpesh kryen, përveç auditimeve të çështjeve rajonale, auditime të autoriteteve të administratës publike të rëndësishme për operacionet shtetërore dhe sigurinë e qytetarëve. Në vitin 2018, Dega Rajonale në Varshavë koordinoi auditimin *Përdorimi i pasurive komunale në bazë të marrëveshjeve të qirave dhe huave.* Dega Rajonale ka audituar, gjithashtu, *Pagesat për menaxhimin e kompanive strategjike të Thesarit të Shtetit në vitet 2011-2017; Auditimi dhe efiçienca e procedurave përmbartimore të kryera nga autoritetet e mbikëqyrjes së ndërtimeve; Mbikëqyrja e guvernatorëve të provincave mbi procesin e legjislacionit të njësisve të qeverisjes vendore, Mbrojtja e intimitetit dhe dinjitetit të pacientëve në spital.*

- **Dega Rajonale e NIK-ut në Wrocław**

Wrocław, kryeqyteti i Silesisë së Ulët, është një nga qendrat më të mëdha të biznesit dhe kulturës në Poloninë perëndimore. I ndërtuar nga rrënojat e kohës së luftës, Wrocław është gjithashtu një nga qytetet më tërheqëse të Polonisë për vizitorët. Për vite të tëra, ajo është listuar në renditjen evropiane dhe globale si një ndër qytetet që ia vlen të vizitohen, si atraksione turistike ose si ndër "qytetet më të mira për të jetuar".

Dega Rajonale e NIK-ut në Wrocław ka audituar rregullisht zbatimin e *Projektit për Mbrojtjen e Përmblyjes në pellgun e lumit Oder duke përdorur një kredi të Bankës Botërore*, dhe ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të atij Projekti. Në vitin 2018, Dega Rajonale koordinoi ekzaminimin e auditimeve të pasqyrave financiare të projekteve të mbrojtjes nga përmblytja në pellgjet e Odra dhe Vistula, të bashkëfinancuara nga kredia e Bankës Botërore; Kryerja e të drejtave dhe detyrimeve të trashëgimtarëve nga bashkitë; Programi i ndërtimit të pishinave të mbyllura të shkollave të vogla "Dolnosląski delfmek" ("LowerSilesian Dolphin"); Përgatitja e administratës publike për të ofruar shërbime për të huajt; Përgatitja dhe përdorimi i objekteve sportive për Lojërat Botërore 2017.

VII. Bashkëpunimi ndërkombëtar i NIK

Bashkëpunimi i Zyrës Supreme të Auditimit me institucionet e tjera, si dhe pjesëmarrja aktive në organizata ndërkombëtare, nxisin shkëmbimin e njohurive dhe përvojës, gjë që rrit efektivitetin e auditimeve të NIK-ut. Zyra Supreme e Auditimit vlerësohet për profesionalizmin e saj, dhe vlerësohet ndërkombëtarisht si një partner i besueshëm. Në vitin 2018, veprimtaria ndërkombëtare e NIK kishte të bënte me tre fusha në veçanti: auditimin e jashtëm të organizatave ndërkombëtare, aktivitetin brenda grupeve që shoqërojnë SAI-t në nivelin global dhe evropian, dhe mbështetjen e zhvillimit të ofruar për Institucionet e tjera të Auditimit të Lartë, mbi të gjitha vendet e Asociuara në BE.

Në vitin 2000 filloi një kontroll ndërkombëtar i zbatimit të Konventës së Helsinkit, ku morën pjesë Danimarka, Estonia, Finlanda, Lituania, Letonia, Polonia, Rusia dhe Suedia. Kontrolli përfundoi në shtator 2001. Gjatë nëntë viteve (1999-2008) të presidencës polake të Grupit të Punes për Auditimin e Mjedisit, u kryen 22 auditime ndërkombëtare dhe mbi 400 auditime kombëtare. Kjo kontriboi në identifikimin dhe eliminimin e shumë parregullsive në fushën e mbrojtjes së mjedisit në Evropë, duke përfshirë mos respektimin e ligjit vendor dhe ate ndërkombëtar.

Pjesëmarrja në auditimet ndërkombëtare

Zyra Supreme e Auditimit ka marrë pjesë në auditime ndërkombëtare të kryera së bashku me Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve të tjera, bazuar në programe të dakorduara. Në vitin 2018, janë kryer shtatë auditime të tilla:

No.	Audit Title	Participating states
1.	Functioning of the "East Carpathians" International Biosphere Reserve	Ukraine, Slovakia, Poland
2.	Support of Tourism by Means of the EU Funds	Slovakia, Poland
3.	Air Quality (national audit: Protection of Air against Pollution)	Bulgaria, Estonia, Hungary, Spain, Romania, Slovakia, Albania, Georgia, Kosovo, Israel, Macedonia, Moldova, Switzerland, Poland, European Court of Auditors
4.	Functioning of the JASPERS Initiative	Croatia, Poland, European Court of Auditors
5.	Transboundary Movement of Hazardous Waste in the Light of the Basel Convention	Poland, Slovakia, Ukraine
6.	Performance of Tasks Related to VAT MOSS Settlement in Poland	Czech Republic, Germany, Poland
7.	Preparedness for Implementation of Sustainable Development Goals	About 60 SAIs globally, including NIK; the audit is coordinated by the INTOSAI Development Initiative IDI

Auditimi i organizatave ndërkombëtare ¹⁹

Këshilli i Europës (Council of Europe)

NIK u caktua si auditees i jashtëm i Këshillit të Europës për periudhën 2014-2018. Mandati i tij përfshinte një auditim paraprak dhe final të pasqyrave financiare dhe llogarive buxhetore për secilin vit.

Organizata Europiane për Kërkimin Nuklear (CERN)

Rezultatet e auditimit të 2017 dhe atij të fundit të kryer nga NIK, u prezantuan zyrtarisht në Qershor 2018 në Gjenevë. Puna e grupit polak rezultoi, ndër të tjera, edhe në paraqitjen e disa rregulloreve të reja të cilat përcaktonin procedurat e prokurimit public.

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

Në 2018, oferta e dhënë nga NIK-u për të audituar OECD-në u përzgjodh si fitues dhe NIK u shpall auditues i jashtëm i OECD për një afat 4-vjeçar, duke nisur me auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018.

Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë është gjithashtu e angazhuar në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe perceptohet si një partner i besueshëm dhe profesional. Kështu, NIK-u ka marrë pjesë në projekte të shumta binjakëzimi, me synim fuqizimin dhe zhvillimin institucional të SAI-ve kandidate dhe potenciale kandidate për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

¹⁹ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 29.

INTOSAI – Organizata Nderkombetare e Institucioneve Supreme te Auditimit



Kryeson: Nënkomitetin e Standarteve të Kontrollit të Brendshëm

Anëtar:

Komiteti i Shkëmbimit të Njohurive

Grupi i Punës për Auditimin e I.T.

Grupi i Punës për Auditimin Mjedisor

Grupi i Punës për Evaluimin e Programeve

Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit

Grupi i Punës për Faktorët Kyc të Indikatorëve Kombëtar

Grupi i Punës për Modernizimin Financiar dhe Reformës Rregullatore

Komiteti Drejtues i INTOSAI-t

Bashkëpunim me Donatorët FAC Task Force për Parashikimet Financiare të INTOSAI-t

Nënkomiteti 3: Promovimi i Praktikave më të Mira dhe Sigurimi i Cilësisë nëpërmjet Peer-Review

NIK-u polak i dedikon një pjesë të rëndësishme aktivitetit të tij ndërkombëtar në pjesëmarrjen në struktura dhe projekte të ndryshme të INTOSAI-t. NIK ka qenë një anëtar i INTOSAI-t që prej vitit 1959 dhe i përfshirë aktivisht në veprimtarinë e kësaj organizate. NIK-u polak është anëtar i Bordit Qeverisës të Organizatës, ashtu sikundër dhe i komiteteve dhe grupeve të punës të INTOSAI-t. Në 2018, u bënë dhe përgatitjet për mbajtjen e Kongresit të XXIII-të të INCOSAI-t në Moskë.

SAI polak ka përfaqësuesit e tij në tre komitete sektoriale të Organizatës: Komiteti i Standardeve Profesionale, Komiteti i Ndërtimit të Kapaciteteve dhe Komiteti mbi Shkëmbimin e njohurive.

Për më tepër, NIK-u polak merr pjesë edhe në Grupin e Punës në Luftën Kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave, i cili në 2018 vazhdoi me hartimin e Udhëzuesit për Auditimin e Parandalimit të Korrupsionit në Prokurimin Publik.²⁰

NIK-u polak ka qenë gjithashtu udhëheqës i Grupit të Punës për rishikimin e ISSAI-t 30 "Kodi i Etikës", nën lidhshirë dhe i Z. Jezierski, dhe i cili u aprovua në Kongresin e XXII të INCOSAI-t në Abu Dhabi.

Zhvillimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar të SAI-ve pas viteve '90²¹

Në shkrimin e tij mbi INTOSAI-n, ish Presidenti i NIK-ut polak, z. Jacek Jezierski ndan me lexuesit reflektimet e tij:

"Qëndrimi ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare e NIK-ut ndryshoi rrënjësisht pas transformimit demokratik në Poloni në fillim të viteve 1990. Atëhere, NIK filloi të bashkëpunojë me SAI të tjera, në nivel rajonal duke u përfshirë në iniciativa të organizatave ndërkombëtare siç është INTOSAI dhe EUROSAI.

Këto dy organizata kanë ndryshuar shumë gjatë dy dekadave të fundit. Këto ndryshime i atribuohen pjesërisht qëndrimeve të reja ndaj bashkëpunimit me anëtarët ndërkombëtarë, që vijnë si pasojë e ndryshimeve demokratike në vendet e tyre- siç është rasti i NIK. Një grup i SAI-t është i interesuar në një bashkëpunim real sesa në një anëtarësim formal në INTOSAI. SAI-t e ristrukturuara nga ish vendet

²⁰ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 24.

²¹ Reflektimet Fjala e ish-Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit (NIK) të Polonisë, Jacek Jezierski, botuar në botimin "60 vjet INTOSAI-50 vjet Sekretariati i Përgjithshëm", 2013.

totalitare, jo vetëm nga Europa Qëndrore dhe Lindore, por edhe nga pjesa tjetër e botës, ndaluan së qeni anëtar pasiv të organizatave ndërkombëtare dhe u bënë bërthama aktive të tyre, duke ndarë njohuritë, eksperiencën dhe praktikat më të mira. Një numër i madh i grupeve të punës u formuan në INTOSAI, si rezultat i temave dhe rekomandimeve të INCOSAI.

Grupi i punës për auditimin mjedisor i formuar në vitin 1992, ku NIK-u është anëtar, jep një shembull të shkëlqyer se si INTOSAI kontribon për ndarjen e eksperiencave dhe njohurive në lidhje me sfidat që SAI-t përballet, siç janë proceset ekonomike dhe sociale të një bote moderne dhe çfarë duhet të jetë subjekt për tu audituar. Grupi i Punës ka përpunuar disa guida duke përfshirë këshilla dhe shembuj që lidhen me auditimin e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshmërisë. Grupi organizon seminare dhe trajnime si edhe ofron një forum për ndarjen e eksperiencave dhe njohurive. Ky grup gjithashtu ka ndërmarrë auditimin e parë global, në të cilin SAI-t e të gjithë vendeve të botës morën pjesë. Veç kësaj, grupi bashkëpunon ngushtësisht me partnerët e jashtëm, përfaqësuesit e tyre morën pjesë në Samitin e tokës në vitin 2002 në Johannesburg, në Kongresin Botëror për Drejtësi dhe në Samitin e Tokës në vitin 2012 në Rio de Janeiro.

Revolucioni global në teknologjinë e komunikimit që mund të vërehet vitet e fundit ka prekur funksionimin e INTOSAI-t. Marrëdhëniet midis anëtarëve të INTOSAI-t janë bërë më të thjeshta falë mjeteve të reja të komunikimit. Bashkëpunimi brenda INTOSAI-t nuk është më formal siç ka qenë më parë dhe pjesëmarrësit nuk janë më vetëm në nivel drejtuesish të lartë dhe departamenteve të marrëdhënieve me jashtë. Në ditët e sotme, bashkëpunimi i INTOSAI-t ndodh në nivele të ndryshme, nga Drejtuesit e SAI-ve deri te punonjësit që merren direkt me auditime dhe trajnime, të cilët mund të kenë impaktin më të madh në rezultatin final të bashkëpunimit.”

Zhvillimet më të fundit në INTOSAI

Në vitin 2004, INTOSAI adoptoi Planin Strategjik për periudhën 2004-2010. Ai përcaktoi vlerat e organizatës dhe identifikoi objektivat bazë strategjike në të cilat duhet të përqëndrohen aktivitetet e saj. Zhvillimet e këtij plani frymëzuan Brodin Drejtues të EUROSAT-t, në të cilën SAI i Polonisë kishte nderin të kryesonte për vitet 2008-2011. Ne besuam që EUROSAT, si një Grup Pune Rajonal i INTOSAI-t, duhet të merrte pjesë në mënyrë aktive në implementimin e Planit Strategjik. Ne gjithashtu menduam që kjo mund të bëhej njëkohësisht në dy drejtime: së pari me përfshirjen direkte të anëtarëve tanë në iniciativat e INTOSAI-t dhe së dyti duke implementuar Planin tonë Strategjik Rajonal, i cili në një masë të madhe, do të ishte i pajtueshëm me atë të INTOSAI-t. Tek punonim për zhvillimin e Planit Strategjik të EUROSAT-t, ne vendosëm të ndërtonim diçka në lidhje me përvojën e INTOSAI-t. Kjo është arsyeja që ne ftuam përfaqësuesit e Sekretariatit të INTOSAI-t për të marrë pjesë në ekipin e Planit Strategjik, së bashku me përfaqësuesit e EUROSAT-t të cilët ishin angazhuar për zhvillimin e Planit të Parë Strategjik të INTOSAI-t.

Njohuritë dhe përvoja e tyre bënë që përpunimi i Planit Strategjik të EUROSAT-t të bëhej në mënyrë të qetë dhe efektive. Ne supozuam që EUROSAT, si një Grup Pune Rajonal i INTOSAI-t, duhet të kishte të njëjtat objektiva strategjike. Njëherazi, u vendos që objektivi në lidhje me standartet ndërkombëtare profesionale duhet të promovonte dhe lehtësonte implementimin e këtyre standarteve sesa të fokusohet në zhvillimin e tyre, në mënyrë që të mos kishte mbivendosje me punën e INTOSAI-t. Në mënyrë të ngjashme, ndërkohë që propozoheshin aktivitete dhe projekte për objektivat individuale të EUROSAT-t, iu kushtua një vëmendje e veçantë mospërkimit me iniciativat e INTOSAI-t, por maksimizit të përdorimit të efektshëm të produkteve të tyre për zhvillimin e auditimit të sektorit publik në rajonin Europian.

Grupe të tjera pune rajonale, jo vetëm EUROSAT, janë duke zhvilluar planet e tyre strategjike. Kjo vërteton faktin që INTOSAI konsiderohet si një partner me influencë. Shembulli i të cilit ndiqet dhe zëri i dëgjohet. Strategjia dhe iniciativat e reja janë në kuadrin e strukturës së re dhe e bëjnë INTOSAI-n më të dukshëm në arenën ndërkombëtare.

Përpjekjet e bëra nga Sekretariati i Përgjithshme i INTOSAI-t për planin strategjik gjate viteve 2004-2010, rezultuan në inkorporimin e Deklaratës së Limës dhe Meksikës, dy dokumeta kyç të INTOSAI-t në ligjet ndërkombëtare: Në dhjetor të vitit 2011, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adoptoi rezolutën e titulluar Promovimi i efiçencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës publike duke forcuar Institucionet Supreme të Auditit. Për herë të parë, Asambleja e Përgjithshme njohu që SAI-t mund të përmbushin në mënyrë efektive dhe objektive mandatet e tyre vetëm nëse kryejnë auditime të pavarur dhe të mbrojtur kundrejt influencave të jashtme. Në këtë mënyrë, u nënvizua fakti i rëndësishëm së promovimit të efiçencës, efektivitetit, llogaridhënies dhe transparencës nga ana e SAI-ve . Në të njëjtën kohë, Kombet e Bashkuara inkurajuan shtetet anëtare për të aplikuar parimet e Deklaratës së Limës dhe Meksikës, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me INTOSAI, në fushën e ndërtimit të kapaciteteve.

Një arritje tjetër e padiskutueshme e INTOSAI-t në vitet e fundit është zhvillimi i Standarteve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) promovimi dhe implementimi i të cilave garantojnë cilësinë e punës së SAI-t, shtojnë rëndësinë e tyre dhe forcojnë auditin e sektorit publik. Duke ndjekur INCOSAI 2010 dhe miratimin e 37 standarteve (ISSAI) të reja, INTOSAI ka tashmë një gamë të gjerë standartesh dhe manualesh të reja. Në mënyrë që të kenë një kornizë të përbashkët reference, standartet e ISSAI duhet tu bëhen të njohura SAI-ve dhe partnerve të jashtëm. Që kjo gjë të jetë e arritshme, Sekretariati i Përgjithshëm doli me një iniciativë për të përgatitur një përmbledhje ekzekutive të standarteve, në mënyrë që të jenë më lehtë për tu trajtuar. Plani Strategjik i dytë i INTOSAI-t, për vitet 2011-2016, përmban implementimin e ISSAI-it si një nga gjashtë përparësitë e INTOSAI-t.

Sfidat e ardhshme të INTOSAI

Sfidat me të cilat përballen INTOSAI dhe anëtarët e tij nuk kanë ndryshuar shumë. Ka shumë raste që SAI-ve të ndryshëm u çenohet pavarësia dhe ka raste të aktiviteteve të ndryshme që synojnë të kufizojnë kompetencat e tyre. Për më tepër, kriza ekonomike financiare solli rritjen e presionit ndaj shumë vendeve, që SAI-t respektive, të provojnë që vendet e tyre kanë shpenzuar burimet në mënyrën më efektive. Pritshmëritë rreth punës së tyre janë në rritje të vazhdueshme, duke qënë se, media, shoqëria dhe legjislacioni kombëtar shpreson se SAI-t do të kontribuojnë në përdorimin sa më të mirë të burimeve publike, për një qeverisje sa më të mirë dhe në luftën ndaj korrupsionit.”.

EUROSAI – Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit



Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) është një nga grupet e punës rajonale të INTOSAI-t. Standardet dhe udhëzimet lidhur me auditimin publik hartohen në nivel global, ndërsa organizatat rajonale, përfshirë EUROSAI, mbështesin zbatimin e tyre në punët e përditshme të SAI-ve.

NIK-u është ne mesin e 50 vendeve anëtare të EUROSAI-t.

Zotit Jezerski, në cilësinë e presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, iu besua funksioni prestigjioz i Kryetarit të Bordit Drejtues të EUROSAI në Kongresin e VII të EUROSAI në Krakov, në qershor 2008²². Përfaqësuesi i lartë i nderit ishte presidenti z. Kaczyński, i cili e vlerësoi NIK-un si **”shkollë dhe universitet i dijes”**.

Në 2018, NIK mirëpriti një takim të stafit përgjegjës për metodologjinë në institucionet supreme të auditimit të Europës, të iniciuar së bashku me SAI Suedez, e cila kishte në fokus përfshirjen aktive të anëtarëve të EUROSAI-t në ato projekte që adresonin nevojat e tyre. U përgatit një listë me pritshmëri

²² Revista e EUROSAI , Presidenca 2008-2011, Warsaw 2011

dhe sfida, në lidhje me sigurimin e cilësisë së auditimit si dhe me planifikimin dhe komunikimin e auditimit mes SAI-ve dhe palëve të interesit. Ky event u prit me shumë interes nga pjesëmarrësit dhe një seri takimesh të tilla priten të organizohen në të ardhmen. NIK-u, së bashku me SAI Suedez dhe ECA-m, ka punuar mbi projektin e trajnimit online të anëtarëve të EUROSAT-t.

Në 2018, NIK vazhdoi të kryesonte Grupin e Punës së EUROSAT-it mbi auditimin IT nga ku u zhvillua projekti i bazës elektronike të raporteve të auditimit i quajtur "Kubi"-projekt ky i kryesuar nga NIK, projekti i vetëvlerësimit të SAI-ve lidhur me auditimet IT si dhe vetëvlerësimit me mjeteve IT të përdorura nga SAI-t (Vetëvlerësimi i mjeteve IT), si dhe kryerjen e auditimeve paralele mbi çështjet e IT²³.

- **Bashkëpunimi me Gjykatën Europiane të Audituesve-ECA²⁴**

NIK bashkëpunon me Gjykatën Europiane të Audituesve në lidhje me auditimet e kryera nga ECA në Poloni, në kuadër të angazhimeve me BE-në. Audituesit e NIK-ut marrin pjesë në auditimet që ECA kryen në Poloni si vëzhgues, analizojnë komentet e institucioneve kombëtare për gjetjet audituese paraprake dhe në disa raste bëjnë komente mbi këto gjetje. Në 2018, ECA realizoi 21 auditime në Poloni.

Mandatet e NIK-ut dhe ECA-s për të audituar menaxhimin dhe përdorimin e fondeve të BE-së nga autoritetet e Polonisë (administrata, përfituesit etj.) hasin mbivendosje. Po ashtu, nuk ka as rregullime në nivel kombëtar as në nivel evropian për përcaktimin e qartë të mandateve dhe procedurave të tyre, si dhe mbi efektet ligjore të veprimeve të tyre të përbashkëta ose të koordinuara. Për pasojë, për një bashkëpunim më efektivë, kërkohen disa rregullime më të qarta.

- **Bashkëpunimi me KLSH-në 2012-2019**

Bashkëpunimi historik filloi formalisht pas viteve '90. KLSH nënshkroi me ish president Januz Vojçeçovski në vitet 2000 një marrëveshje e cila nuk u vu në praktikë. Ishte vetëm falë vullnetin dhe gatishmërisë së z.Jezerski që KLSH dhe NIK-u u kthyen në dy partnerë të rëndësishëm. Gjatë vizitave të mia të para në cilësinë e Kryetarit të KLSH, në qershor 2012 në Poloni, së bashku me Presidentin Jezerski rinovuam marrëveshjen e bashkëpunimit mes KLSH-së dhe NIK-ut Polak, e cila kishte mbetur në letër që kur ishte nënshkruar në vitin 2006.

Në periudhën 2012-2015, falë vullnetit të mirë dhe vizionit të ish-Presidentit të NIK-ut, z.Jacek Jezerski, një mik i madh i KLSH-së dhe shqiptarëve, NIK organizoi trajnime për pothuajse të gjithë audituesit e KLSH-së në fushën e auditimeve financiare, të përputhshmërisë, performancës dhe teknologjisë së informacionit në Qendrën Trajnuese Goluvice të NIK-ut në Varshavë.

Me ish-presidentin e NIK, Z.Kristof Kiatovski, në mars 2016 në Varshavë nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit përmes së cilës të dy institucionet u angazhuan dhe u zotuan në arritjen e objektivave të Projektit të Binjakëzimit IPA 2013, së bashku me SAI-n Kroat, në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira evropiane. Ky projekt i realizuar përgjatë periudhës mars 2016-korrik 2018 ishte i një rëndësie madhore për KLSH-në, pasi institucionit dhe audituesve shqiptarë u dha mundësia që të njiheshin me eksperiencën e audituesve të NIK-ut dhe praktikën më të mira. Përvoja e përfituara nga projekti IPA është mjaft e rëndësishme dhe ka ngritur një shtyllë të re për progresin e KLSH-së, përgjatë rrugëtimit të tij si një SAI modern evropian.

Projekti u drejtua me profesionalizëm dhe përkushtim të madh nga ish zv/presidenti i NIK, z.Vojçek Kutula.

Projekti i Binjakëzimit²⁵ është formati origjinal i BE-së për zhvillim dhe bashkëpunim që bazohet në parimin se zgjidhjet duhet të vinë nga puna praktike e jo përmes teorive. Në kuadër të negociatave të

²³ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 25.

²⁴ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 27.

²⁵ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office "A century of NIK's service to the Polish State", Warsaw 2018, fq. 412.

anëtarësimi me Brukselit, institucionet e vendeve që aspirojnë anëtarësinë në BE duhet të tregojnë se veprojnë sipas standardeve europiane. Pikërisht, për të siguruar një gjë të tillë, zbatohet formula e binjakëzimit e cila ka në fokus shkëmbimin e eksperiencave dhe dijes mes institucioneve të vendeve anëtare dhe atyre aspiruese. Një SAI mëson nga një SAI, një bankë qendrore nga një bankë qendrore etj. NIK-u polak së bashku me SAI-n e Kroacisë ishin shembujt europiane për KLSH-në europiane.

Projekti mori hov kur në cilësinë e Kryetarit të KLSH-së i përcolla një kërkesë Presidentit Jacek Jezierski për organizimin e një serie trajnimesh për audituesit shqiptarë. Projekti i binjakëzimit në KLSH përfshiu zbatimin praktik të disa lloje auditimesh si : auditimin financiar, auditimin e performances, auditimin e përputhshmërisë si dhe auditimin IT, që ka ardhur në rritje. Ekspertët nga Polonia dhe Kroacia (megjithëse në grupet e punës kishte ekspertë edhe nga Holanda, Portugalia dhe Estonia) kanë zhvilluar një sërë takimesh me audituesit shqiptarë me qëllim forcimin e kapaciteteve të tyre në përputhje me përgatitjen profesionale të kërkuar nga BE. Së bashku me kolegët polakë, kemi hartuar rregullore dhe manuale të reja për auditimet, kemi përmirësuar planet e punës, programet e auditimit si dhe raportet përfundimtare. Projekti i binjakëzimit 28 mujor u zbatua me kërkesë të Komisionit Europian në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe u përfundua në korrik 2018. Kjo iniciativë u fokusua në forcimin e kapaciteteve të auditimit të jashtëm publik në Shqipëri dhe u shoqërua me një sërë aktiviteteve individuale bazuar në tre komponentë: (1) Përmirësimin e kuadrit rregullator për auditimit (2) Zhvillimin e metodologjive audiuese dhe kapaciteteve raportuese dhe (3) Forcimin e kapaciteteve institucionale të KLSH-së dhe rritjen e impaktit të punës audiuese të KLSH-së.

U organizuan rreth 100 misione, me rreth 70 ekspertë nga 5-shtete të BE-së: Polonisë, Kroacisë, Hollandë, Estoni dhe Portugali.

NIK po ashtu ka mbështetur Zyrën Kombëtare të Auditimit Kosovës në anëtarësimin në komunitetin e INTOSAI, e cila u miratua gjatë kongresit të XXIII të INTOSAI-t të zhvilluar në Moskë në 23-27 shtator 2019.

VIII. Publikimet e përvjetorit²⁶

Me rastin e përvjetorit të 100-të të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, u publikua albumi “Zyra Supreme e Auditimit 1919-2019. Një shekull në shërbim të shtetit. Ky volum paraqet historinë 100-vjeçare të NIK-ut polak përmes imazheve të personaliteteve që kanë shenjuar institucionin polak nga 1919 deri në ditët e sotme.

Publikimi i dytë në këtë përvjetor është libri “100 auditime. Dosjet e Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë.” Për herë të parë në historinë 100-vjeçare të NIK-ut, rezultatet e auditimeve dhe prapaskenat e tyre prezantohen në një mënyrë kaq tërheqëse. Autorët e kanë nisur që me fillimet e funksionimit të tij, aktivitetin emigrues, kohërat e vështira të Republikës Popullore Polake, e deri në auditimet e viteve të fundit.

Marrëdhëniet me publikun

Esenca e marrëdhënieve efektive me publikun të institucioneve publike është arritja e çështjeve specifike tek një numër sa më i madh i mundshëm. Në aktivitetin e tij, NIK-u nuk bashkëpunon vetëm me median tradicionale, por i kushton një vëmendje gjithnjë e në rritje komunikimit përmes medias sociale.²⁷

Publikimet tona për NIK-un polak

- 100 Simbolet Polake
- Zyra Supreme e Auditimit: Tradita dhe Bashkëkohësia
- GAO, NIK-u dhe leksione nga Dodaro (në proces publikimi, në respekt të NIK-ut polak, botim ky i cili është përgatitur gjatë vizitës time tremujore në fillim të vitit 2019)

²⁶ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 70.

²⁷ NIK 1919-2019, Supreme Audit Office, Warsaw 2019, fq. 34.